



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Nr. 12, datë 23.12.2025

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit
Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:15

Data e mbajtjes së mbledhjes : 23.12.2025

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Kryetari i Bashkisë znj. Emiriana Sako si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Denisa Luarasi: Të nderuar këshilltarë !E nderuar kryetare ! Të nderuar nëpunës të Bashkisë Durrës !Të nderuar pjesmarrës!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës për muajin Dhjetor të Këshillit Bashkiak Durrës.

Kjo është mbledhja e fundit për këtë vit dhe do të marrim disa vendime të rëndësishme për zhvillimin e qytetit. Në këtë mbledhje përmbyllëse kemi detyrimin institucional të zhvillojmë një debat serioz, të përgjegjshëm dhe korrekt duke respektuar procedurat, mendimet e ndryshme dhe interesin publik. Ju ftoj të kontribuojmë me qetësi, profesionalizëm dhe frymë bashkëpunimi në mënyrë që vendimmarrja jonë të jetë në lartësinë e përgjegjësisë që na kanë dhënë qytetarët. Kjo mbledhje plenare e Këshillit do të shqyrtojë edhe projektbuxhetin afatmesëm të bashkisë Durrës për vitet 2026-2028 si dhe projektvendime të tjera të propozuara nga kryetarja e bashkisë. I gjithë dokumentacioni ju është vënë në dispozicion në postën elektronike nga sekretarja e këshillit. Ftoj sekretaren të bëjë prezencën në sallë.

Dorina Milja: Përshëndetje ! Fillojmë...

Ardian Mukaderi tek.... Florian Tahiri...

36 këshilltarë në sallë.

V.O. (Hyn me vonesë në sallë këshilltarët: Aldo Çelaj, Silvana Agasi, Erzen Laçi. Gjatë mbledhjes ikin nga salla këshilltarët Bledar Prizreni, Suada Çurri, Arlind Boshku. Gjithsej gjatë mbledhjes 39 këshilltarë).

Denisa Luarasi: Faleminderit Dori.

Meqë kurumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen. Sot kemi për shqyrtim dhe miratim 9 pika. Po ju lexoj rendin e ditës.

Pika 1.	PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM (PBA) PËR VITET 2027-2029 DHE BUXHETIT VJETOR
Pika 2.	PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2026 DHE PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028
Pika 3.	PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E DURRËSIT PËR VITIN 2026
Pika 4.	PËR MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ME VLERË TOTALE 50'572'489 (PESËDHJETË MILIONË E PESËQIND E SHTATËDHJETË E DY MIJË E KATËRQIND E TETËDHJETË E NËNTË LEKË), PËR LIKUIDIMIN E PLOTË TË DISA FAMILJEVE DHE PËR LIKUIDIMIN ME KËST TË PJESËS TJETËR, TË DËMTUARA NGA PËRMBYTJET E SHKAKTUARA NGA RESHJET INTENSIVE TË SHIUT TË DATAVE 29.01.2025 – 30.01.2025
Pika 5.	PËR MIRATIMIN PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.05, DATË 10.03.2025, “PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 400 703.84 (KATËRQIND MIJË E SHTATËQIND E TRE, PIKË TETËDHJETË E KATËR) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, SIPAS TABELËS SË HARTUAR NGA GRUPI I PUNËS, I NGARKUAR PËR KRYERJEN E VLERËSIMIT PARAPRAK, DHE ËSHTË PJESË E KËTIJ VENDIMI, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “RIKONSTRUKSION RRUGE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ISHËM”
Pika 6.	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN DHJETOR 2025

Pika 7.	PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË PROGRAMIT TË KREDISË SË LEHTËSUAR PËR STREHIM ME 3% INTERES
Pika 8.	PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË ZONAVE PRIORITARE TË ZHVILLIMIT NË TERRITORIN E BASHKISË Durrës NË PËRPUTHJE ME PARASHIKIMET E LIGJIT NR. 20/2025, "PËR PAKETËN E MALEVE" DHE UDHËZIMIT TË MINISTRIT TË PUSHTETIT VENDOR NR. 2, DATË 15.10.2025
Pika 9.	PËR MIRATIMIN E LISTES EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, QË PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE DHE PAGESAVE PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026

Keni ndonjë koment?

Jeni dakort me rendin e ditës?

Dorina Milja: 37 se erdhi dhe Aldo.

Denisa Luarasi: Po, me 37 vota pro miratohet rendi i ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 1** Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj

Jonida Musaraj: Përshëndetje të gjithëve.

Atëherë për pikën 1, ne si komision e miratuam, e votuam dhe ftojme anëtarët sot që të japin votën pro. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave- Tarifave, zoti Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Përshëndetje.

Edhe komisioni jonë, dua të theksoj vetëm me pjesëmarrjen e këshilltarëve të Partisë Socialiste, e miratoi dhe fton të gjithë këshillin ta miratojë, ta votojë.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Xhelilaj.

Komente?

Pyetje kemi për pikën 1?

Kalojmë në votim.

Kush është pro për pikën 1 të rendit të ditës?

Me 37 vota pro miratohet pa ndryshime pika 1 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 2** Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Jonida Musaraj: Atëherë dhe në lidhje me këtë dokument të rëndësishëm komisioni ynë e miratoi dhe e ftojme këshillin që t'i japi votën pro. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zonja Musaraj.

Komisioni i Buxhetit, Financës, Taksave -Tarifave zoti Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Ashtu siç thatë ju zonja nënkryetare në rolin e kryetarit të Këshillit Bashkiak, pika një, dy, tre, katër për Këshillin Bashkiak në këtë mbledhje janë shumë të rëndësishme, sepse përbëjnë thelbin e një pune njëvjeçare të Këshillit Bashkiak, por sidomos përgatitjen edhe për një periudhë tjetër njëvjeçare me buxhetin e bashkisë. Ishte pakuptim mospjesëmarrja në mbledhje të komisionit e palës tjetër. Megjithatë, duke vlerësuar buxhetin e paraqitur komisioni i buxhetit me pjesëmarrjen vetëm të anëtarëve këshillit nga Partia Socialiste miraton dhe fton gjithë këshilltarët ta votojnë.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Xhelilaj.

E kërkon fjalën kryetarja.

Flutura Kasa: Ka mundësi vetëm diçka? Meqënëse kjo është edhe pika më kryesore dhe para një viti kena pasur shumë debate. Ka mundësi Denis, ka mundësi të respektoni kohën dhe jo ashtu: “Ja jap unë minutat e mia, ja jap unë minutat e mia”. Të gjithë kemi të drejtë me respektu kohën se nuk do ketë tashi biseda pafund. Të lutem. E kena..e di...e di po.. çdo vit për këtë flasim.

Denisa Luarasi: Nëse ishe e vëmëndshme....

Faleminderit. Faleminderit

Emiriana Sako: Faleminderit.

Kemi bërë një përmbledhje të shkurtër të buxhetit. Siç e parashikon ligji i gjithë plani i buxhetit trevjeçar është dorëzuar 5 ditë përpara mbledhjes dhe gjithsecili nga ju ka pasur mundësi që ta studiojë. Ne kemi marrë kërkesat nga dëgjesat publike, kemi marrë kërkesat nga administratorët e njësive, kemi marrë gjithashtu edhe kërkesat që na vijnë nga qytetarë të ndryshëm, që ngrejnë shqetësime për infrastrukturën apo për komunitetet në lagjet ku banojnë dhe gjithashtu së bashku dhe me vizionin që kemi pasur për mandatin katërvjeçar kemi vënë në plan disa projekte që i mendojmë si të rëndësishme. Dhe unë në fakt sot kam bërë një përmbledhje kryesisht me produkte, pra me një buxhet sipas programeve dhe programet kemi tentuar t'i bashkojmë. Janë 22 programe, 22 funksione të bashkisë, të cilat shkurtimisht i kemi përmbledhur në një prezantim të shkurtër që të bëhet pak më i kuptueshëm edhe për qytetarët, meqënëse kemi dhe prezencën e mediave.

Atëherë vlera e buxhetit total, këtu do të flasim vetëm për buxhetin e 2026-s, pra nuk do të jetë një prezantim trevjeçar, por vetëm për vitin që vjen. 2025-a ka pasur një vlerë prej 64.9 milion dollar buxheti i rishikuar, pra me gjithë ndryshimet e ndodhura gjatë vitit dhe për 2026 kjo vlerë shkon në 68.5 milion dollar dhe kemi një rritje 6% nga viti 2025.

Burimet kryesore të të ardhurave tona janë burimet tona të mbledhura nga taksa, tarifatat që pagojnë qytetarët e Durrësit. Është një fond i trashëguar nga viti i shkuar. Janë taksat e ndara 6 % , të cilat vijnë kryesisht nga institucionet qendrore, por që ë kalojnë në bashkinë e Durrësit dhe është

transferta e buxhetit qëndror me 37% ku futen transfertat e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara. Këtu nuk kemi reflektuar fondet që ne si bashki marrim për investime të ndryshme gjatë vitit duke aplikuar në Ministrinë e Linjës apo dhe në Fondin Shqiptar të Zhvillimit.

Të ardhurat e veta. Kemi bërë një tabelë që nga viti 2022 kemi rritje me 138% që nga viti 2022. Tre vitet e para janë reflektuar sipas faktit, ndërsa 2025 dhe 26 janë plani dhe sepse 2025 është një vit, i cili financiarisht nuk është mbyllur ende.

Shpenzimet për vitin 2026, pra buxheti ndahet në tre pjesë, në investime 44%, shpenzime korente ku janë kryesisht 602-shi 26% dhe shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore 30%.

Përsa i takon *planit të investimeve*, investime të reja, kemi një rritje 84% nga viti 2025 ku buxheti ishte rreth..., i vitit që mbylлим rreth 10 milion dollar dhe projekti i propozuar, i cili kalon sot për miratim është 18.8 milion dollar, i ndarë sipas funksioneve kryesore si më poshtë. Po e nis dy zërat më të rëndësishëm ose që kanë peshë më të madhe të buxhetit janë arsimit bazë dhe parauniversitar me 17 pikë, sa gati 18% infrastruktura dhe transporti publik me 17% shërbimet publike, menaxhimi i mbetjeve me 14%, planifikimi, menaxhimi dhe administrimi me 12%, kultura dhe sporti 9 dhe kështu me radhë siç e shikoni në tabelën në ekran.

Për të shkuar në disa zëra specifikë të cilat ruajnë një kanë një peshë të rëndësishëm, *investimet në arsim* do të vazhdojnë dhe këtë vit të jenë me prioritet përsa i takon bashkisë së Durrësit. Kemi rindërtimin e gjimnazit “Gjergj Kastrioti”, i cili është një angazhim i marrë me nxënësit, prindët, mësuesit e asaj shkolle për t'u rindërtuar po atje ku ka qenë. Kemi përfunduar projektin dhe me një vlerë rreth 350 milionë ë lekë të reja dhe sigurisht që projekti, kemi qenë shumë të kujdesshëm që projekti të parashikojë edhe ruajtjen e gjetjeve arkeologjike, por i kemi ndarë në dy preventiva dhe pjesën e parkut arkeologjik le ta quajmë, ne do ta aplikojmë pranë Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit për ta financuar dhe ndërsa me pjesën e shkollës do të vijojmë me buxhetin tonë. Kemi përfunduar projektin dhe kemi bërë aplikimin në KKTKM. Presim miratimin aty për të vijuar proceset përkatëse për dhënien e lejeve.

Një projekt tjetër i rëndësishëm i ardhur nga komuniteti i Katundit të Ri është rindërtimi i shkollës së “Bisht-Kamzës”. Kemi hapjen e kopshtit të ri në Manëz. Pra, sapo kemi hapur çerdhen do të vijojmë edhe me në të njëjtën godinë me hapjen e kopshtit dhe në lagjen 17 tek Ujësjiellësi. Gjithashtu, kemi futur në këtë buxhet mobilimin e shkollave dhe kopshteve të reja. Kemi mbulimin e funksionimit të 6 çerdheve ku japim shërbim për gati rreth 700 fëmijë. Kemi rikonstruksin e çerdhes 4, në këtë vit. Kemi bonusin e ekselencës, që ja japin fëmijëve, të cilët dalin me nota 10 absolute në ciklin nëntëvjeçar dhe në ciklin e mesëm. Janë 715 nxënës të shkollave nëntëvjeçare dhe të mesme që mbështeten me bursa. Vaktet ushqimore për 1670 fëmijë. Po në këtë buxhet kemi mirëmbajtjen për 110 godina arsimore gjithashtu dhe një numër i konsiderueshëm fëmijësh që përfitojnë nga zbritja, heqja e tarifës, të cilët përfaqësojnë komunitetet në nevojë. Këtu kemi dhe pagat sigurime shoqërore përsa i takon sistemit arsimor. *Infrastruktura rrugore* dhe transporti është 1.13 miliard lekë apo 17% e buxhetit. Këtu kemi futur investimet në infrastrukturë rrugore për të gjitha njësitë administrative dhe këtë vit kemi dyfishimin e buxhetit për nevojat e këtyre njësiteve. Kemi futur në buxhet me një vlerë 100 milion lekë rikonstruksin e rrugëve, nyjeve të trafikut, trotuarve, sinjalistikës dhe këto janë projekte të cilat ne do t'i detajojmë gjatë vitit. Mendojmë që ka nevojë për..., pra këtu do të fusim dhe rikonstruksin dhe rehabilitimet e akseve të ndryshme. Kemi vendosur sinjalistikën për projektin e parkimeve me pagesë, e cila do të jetë një, do të ketë një buxhet të dedikuar, sepse është dhe një projekt i konsiderueshëm. Kemi pastaj fonde të cilat do t'i kalojnë ndërmarrjeve për

të bërë proceset e tyre të punës për mirëmbajtjen e rrugëve, shesheve dhe ndërmarrjeve. Kemi pasur gjatë këtij viti më tepër ndërhyrje në territor sesa ne kishim parashikuar në buxhet për riparimet nga ana e riparimeve që bëjnë kryesisht OSHE-ja dhe UKD-ja dhe edhe për këtë arsye, por edhe për nevojat e komunitetit kemi bërë rritje të fondit për Ndërmarrjen Rruga në mënyrë që të jemi më efikas në punën në terren.

Një projekt tjetër shumë i rëndësishëm është rehabilitimi i rrugëve dytësore në zonën e Durrësit të ri. Ne vjet në 2024 aplikuam me një fond në Fondin Shqiptar të Zhvillimit dhe kemi bërë rreth 52 rrugë sekondare, të cilat filluan më në veri të zonës së Durrësit të ri apo ish- Kënetës dhe këtë projekt këtë vit do ta shtrijmë edhe më buxhetin tonë, sepse vlerësuam që kishte një nevojë shumë të lartë nga komuniteti në zonë.

Kemi fond për sinjalistikën rrugore, kemi vendosur fond për shpronësimin, i cili zë një vlerë të konsiderueshme për unazat e qytetit. Është një projekt shumë i rëndësishëm, të cilin ne vlerësojmë që duhet të ketë edhe fondet e menjëhershme për shpronësimin pasi preken rreth 300 objekte, banesa, mure, etjera me radhë. Gjithsesi, materiali do t'ju vijë në këshillë për t'u vlerësuar dhe do të vijojmë edhe subvencionimin e biletës së transportit sipas VKB-së të miratuar gjatë vitit 2025. *Tek shërbimet publike* kemi vendosur fondin për blerjen e pemëve dekorative për ndriçimin në qytet. Për rehabilitimin e fasadave të ndryshme jemi fokusuar tek objektet para 90-ës, por mund të ketë dhe objekte, të cilët janë ndërtuar pas viteve 90 që kanë nevojë për ndërhyrje në rehabilitimin e jashtëm të tyre dhe mendojmë që është një fond i domosdoshëm.

Kemi prezantuar për herë të parë “fondin e komunitetit” dhe do të vijmë në këshill me një material të detajuar se si do të funksionojë. Duke qenë se ligji për administrimin e ambienteve të përbashkëta ka ndryshuar dhe i ngarkon banorët me detyra të caktuara, mendojmë që ne si institucion duhet të vijmë në ndihmë që të financojmë një pjesë të punimeve të jashtme me një program të dedikuar, të cilin do ta detajojmë dhe do ta diskutojmë së bashku në këshill. Më tej janë pagat dhe sigurime shoqërore për ata që takon stafeve përkatëse.

Menaxhimi i mbetjeve zë 14% të buxhetit. Këtu kemi vendosur pjesërisht për blerjen e kazanëve, koshave në shëtitore dhe kamera vrojtuese për të monitoruar më tepër ndotësit dhe atje ku zonat që mund t'i kemi kritike. Sigurisht mbulojmë me këtë fond pagat dhe sigurimet shoqërore si dhe depozitimin në landfillën e Sharrës. Nga ana tjetër nuk kemi vendosur investime në flotë, sepse kemi një bashkëpunim me AKEM-in. Mendojmë që brenda vitit do të arrijmë të sigurojmë një numër të konsiderueshëm për shtimin e koshave në qytet dhe disa mjete, të cilat ndërmarrjet kanë nevojë dhe brenda vitit 2026 do të fillojmë dhe programin e rehabilitim, e ndërtimit të një stacioni transferimi, i cili do të bëjë fillimin e procesit të diferencimit të mbetjeve që në burim, por këto janë çështje që do t'i diskutojmë dhe në këshill hap pas hapi dhe sigurisht që do të kërkohet një impenjim maksimal qoftë nga institucionet, por edhe dhe nga qytetarët për t'u vënë jetë.

Në programin tjetër *planifikim, menaxhim dhe administrim* kemi ndërtimin e godinave të njësive administrative Ishëm dhe Katund i Ri, Ndërmarrja Rruga. Dy objektet janë të dëmtuara nga tërmeti i vitit 2019 dhe do të vijojmë me investimet për këto objekte. Kemi futur rikonstruksionin e Qendrës së të Moshuarve me një vlerë 29 milion. Gjithë godina, pra atje ku janë dhe zyrat e Shërbimit Social janë 289 punonjës me paga dhe sigurime shoqërore. Kemi “kuotën e qarkut” dhe vazhdojmë marrëveshjen me ASHK-në për ata që takon fondit. Pra, kemi vendosur sërish dhe këtë vit siç e kemi marrë angazhimin për të vendosur 15 punonjës inxhinierë, kryesisht topografë për të vijuar punën me procesin e legalizimeve në territor.

Përsa i takon *kulturës dhe sportit*, një projekt shumë të rëndësishëm që mendojmë që është prioritet për qytetin e Durrësit është rehabilitimi, rikonstruksioni i pallatit të sportit “Ramazan Njala”. Është një projekt i nevojshëm. Ky projekt vjen në këtë vit së bashku dhe me ndërtimin e terrenit sportiv në Shënvllash si dy projekte prioritare të sportit. Pasi kemi mbaruar parkun “Vala”, por aktualisht kemi dhe dy terrene sportive, të cilat janë në fazë lidhje kontrate. Ai i Katundit të Ri, i cili do të jetë një praktikisht një mini stadium, do të ketë të gjitha standartet, por edhe terreni sportiv në Xhafzotaj në njësinë administrative Rashbull. Do të vijojmë me Shënvllashin dhe sigurisht do të jemi me një urdhër pune të brendshëm në bashkinë e Durrësit. Kemi ngritur një grup pune për të evidentuar të gjitha pronat shtet, të cilat ndodhen në qytetin e Durrësit, në njësitë administrative për të bërë të mundur që të ndërhyjmë pothuajse në çdo njësi me këto hapësira publike apo kënde pushimi apo lojrash për fëmijët. Ky program zë 9% të buxhetit me vlerë 626.5 milion lekë dhe përveç kësaj të kemi dhe risi këtë vit, fondin për thirrjen për grantet për të rinjtë. Është një mbështetje, e cila e fusim si program për herë të parë. Mendojmë që mund të ketë interes edhe të motivojë të rinjtë për të aplikuar për biznese të vogla, për iniciativa të ndryshme për zhvillimin e qytetit. Gjithashtu, kemi elementët e mobilimit të objekteve, të cilat i kemi tashmë në rikonstruksion siç është projekti i Pallatit të Kulturës. Kemi dhe fondin për kulturën rreth 20 milion lekë.

Shërbimet sociale dhe shëndetësia. Kemi parashikuar këtë vit si një projekt të rëndësishëm fondin për rikonstruksionin e qendrave shëndetësore në qytet. Në përgjithësi këto qendra janë bërë rikonstruksion nëpërmjet donatorëve apo qeverisë dhe këtë vit kemi vlerësuar që ka nevojë në disa qendra të qytetit, në disa qendra që ndodhen në qytet për të bërë të mundur ndërhyrjen në këto objekte. Kemi funksionimin e shtatë qendrave sociale ku marrin shërbime 1124 persona përfitues, të cilët janë pjesë e komuniteteve në nevojë dhe vijojmë me programet e tjera të ndihmës ekonomike.

Strehimi social. Këtë vit kemi prezantuar në buxhet një fond të dedikuar për bonusin e menjëhershëm të qerasë. Pra është një program, të cilin ne kryesisht e kemi me qeverinë. Mbasi miratojmë në listat, një pjesë të buxhetit e japim ne me miratimin e Këshillit Bashkiak. Një pjesë të 50%-shit e mbulon qeveria. Kemi menduar që duke qenë se kemi rritje të buxhetit nga viti që shkoi, të vendosim një fond, i cili do të jetë i menjëhershëm për këto familje dhe i jep një farë mënyre pavarësi institucionit të bashkisë për të vepruar më shpejt dhe mos mos të presi procedurat që bëhen nëpërmjet miratimeve në qeveri. Nga ana tjetër, kemi vendosur një bonus qeraje për gratë, të cilat janë në urdhër mbrojtje dhe këtu do të prezantojmë një, do të bëjmë një propozim direkt në të cilin të kemi mundësi mos të bëjmë miratimet përkatëse në këshill, sepse këshilli do kohën e vetë për t'u mbledhur dhe rastet e dhunës në familje nuk presin. Pra, do të bëjmë një mënyrë se si do të shpërndahet ky fond, do ta përcjellim në këshill dhe do të pranojmë gjithë le të kemi diskutim të hapur le të themi, për të diskutuar se si do bëhet likuidimi direkt i atyre grave të cilat janë prej dhunës në familje dhe marrin urdhër mbrojtje nga gjykata. Kemi kredinë për banesat sociale, mirëmbajtjen e banesave sociale, kemi vijimin e projektit për përmirësimin e kushteve dhe objekteve në disa banesa ekzistuese të familjeve në nevojë bashkëfinancim me fondet e qeverisë shqiptare.

Përsa i takon *mbrojtjes civile*, aktualisht zë 3% të buxhetit, pra për 2026. Këtu kemi nisur një projekt shumë të rëndësishëm, i cili mendojmë që është një ndër projektet më të rëndësishme që ka qyteti në këtë moment. Përsa i takon hartimit të projektit për rrjetin e kanalizimeve të ujërave të bardha, pra ujërave të shiut në lagjen 17 dhe në lagjen 14. Gjatë kohës së reshjeve kemi

evidentuar zona të cilat janë problem dhe kemi evidentuar dhe ato momente ku ndodhen problematikat dhe sjellin përmbajtje në zona dhe ky projekt do të parashikojë hartimin e projektit përse i takon zonës së ish burgut, rrugës së Vllazërimit, lagjes 17, zjarrëfikëses, pjesës së zonës së Stadiumit. Dhe gjatë vitit menjëherë me përfundimin e projektit do të vijmë në këshill për të bërë financimin e tij. Kemi bërë të mundur që të fusim në projekt buxhetin e 2026-s ndërtimin e disa zyrave si nevojë e zjarrëfikëseve, e institucionit të zjarrëfikëseve të Durrësit, si dhe blerjen e automjeteve. Gjithashtu kemi dhe fondin e dëmshpërblimit për emergjencat civile.

Projekte të rëndësishme, të cilat i kemi diferencuar le të themi, pasi ne kemi dhe projekte në proces të cilët po i hartojmë, por këtu përveç projektit për të zgjidhur problemin e përmbajtjeve në zonën e Durrësit, kemi projektin për ndërtimin e një shkolle të mesme në lagjen 13. Kemi vështirësi në fakt është një projekt që i mungon kësaj lagje të madhe të qytetit, e cila nuk është vetëm turistike, por popullohet gjatë gjithë vitit dhe jemi duke evidentuar mundësinë e gjetjes së terrenit për të ndërtuar një gjimnaz, pra për të hartuar projektin për një gjimnaz në qytetin, në zonën lagjen 13 të plazhit. Rikonstruksioni i rrugës “Vath Turja” është një projekt shumë i rëndësishëm, i cili ka një gjatësi rreth 8 km. Ne jemi në fazën që do të bëjmë projektin në gjysmën e parë të vitit dhe më tej do të kërkojmë financim pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit se parashikojmë që nevojat për këtë rrugë do të jenë të larta.

Nga ana tjetër kemi caktuar katër zona të qytetit të Durrësit të cilat duam që t'i rehabilitojmë dhe i kemi konsideruar si plane të detajuara vendore. Mendojmë që ka një potencial qoftë lagjja e Kuminit, qoftë grupi i lagjes 2 pas bibliotekës, siç i kam renditur këtu dhe lagjes 9. Më tej lagjja 9 dhe 10 në rrugën Dëshmorët e Stanit, Konturani, Ibrahim Buzhiqi, janë lagje të cilat nga qyteti arrinë deri në pjesën kodrinore nga rruga A Goga arrinë deri në pjesën kodrinore të qytetit dhe sigurisht që mund të kenë një potencial përveç nevojave të shumta që kanë për investime, mund të kenë dhe një potencial për t'u trajtuar si zona që mund të sjellin një zhvillim ekonomik edhe një potencial turistik, pasi kanë dhe një histori shumë të rëndësishme të qytetit. Këto projekte parashikohen me një vlerë 30 milion lekë dhe janë projekte, të cilat do t'i hartojmë gjatë vitit, në mundësitë financimit do t'i buxhetojmë vetë ose do t'i shkojmë Fondit Shqiptar të Zhvillimit përse i takon financimit të tyre. Shumë faleminderit për vëmendjen.

Flutura Kasa: Dorina, Denisa është pa qef nëse është e mundur ta drejtojë mbledhjen dikush tjetër.

Dorina Milja : Duhet të flasë me Denisën.

Flutura Kasa : Isha unë tek ajo dhe sapo më tha ta drejtoj dikush tjetër sa të marr veten.

Dorina Milja : Sipas rregullores, i takon zëvendëskryetares tjetër, por duke qënë se ka dhënë dorëheqjen dhe nuk është këtu prezent, në bazë të rregullores i takon të drejtojë seancën kryetaria e Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike.

Dritan Burgjia : Po kemi zëvendëskryetar tjetër.

Iku..... ka dhënë dorëheqjen? Të dy?

Dorina Milja : Është Denisa, zëvendëskryetari tjetër, që është pa qef.

Dritan Burgija : Ah po, është Denisa.

Rolant Xhelilaj : Kështu që kryetarja e Komisionit të Ligjeve ta drejtojë mbledhjen deri sa Denisa të bëhet më mirë.

Dorina Milja : Po i takon Joniadës me rregullore.

Joniada Musaraj: Atëhere duhet të më mirëkuptoni, sepse më erdhi papritur.

Faleminderit kryetare për prezantimin e projektbuxhetit.

Unë ftoj anëtarët nëse kanë komente ose pyetje në lidhje me buxhetin.

Patjetër zoti Muka.

Ardian Muka: Mirëdita të gjithëve.

Mirëdita kolegë, kryetare.

Më në fund morëm vesh që kryetarja e bashkisë qeka në lartësinë e detyrës, meqënëse kishim një vit pa e parë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak, megjithëse në emër të këshillit i thërret ajo mbledhjet. Megjithatë, e falenderojmë për prezantimin që bëri.

Nga ana formale do kisha dy sugjerime. Vonesa e paraqitjes së buxhetit dhe të paketës fiskale shkuar deri në limitet e afateve kohore, do sugjeroja dhe e kemi thënë edhe në të gjitha mbledhjet e tjera kur diskutohet për buxhetin. Meqënëse këtu mund të kemi sugjerime, këtu mund të kemi kundërshti, tek e fundit votohet dhe në qoftë se buxheti nuk kalon, automatikisht e fusim bashkinë në një periudhë gepi, e fusim në një periudhë vështirësie, sepse mbledhja tjetër sugjerohet që zhvillohet mbas tre javësh. Në këtë pikë do sugjeroja në vazhdimësi të gjitha thëniet e tjera që ne kemi bërë që materiali dhe mbledhja të zhvillohet mundësisht në fillim të dhjetorit.

Përsa i takon prapë anës formale, në paraqitjen që bëri kryetarja e bashkisë, në parashikimin që neve kemi për buxhetin e vitit 2026 për bashkinë, të ardhurat janë 6.8 miliard lekë, 68 miliard lekë të vjetra, të cilat sipas prezantimit janë 68 milion dollar. S'është e vërtetë me kursin e Bankës së Shqipërisë sot janë 83 milion dollar ose në euro janë 70 milion euro. Pra, neve nuk kemi pse ta paraqisim fare në monedha të huaja, por meqënëse u paraqit tashi këtë pjesë është nga ana formale duhet të korrigjohet, sepse nuk është, nuk është ajo.

Atëherë vijmë tek buxheti. Natyrisht që buxheti dhe paketa fiskale janë dy projektet më të rëndësishme që neve marrim shqyrtim si këshill bashkiak ku pjesa e të ardhurave dhe pjesa e shpenzimeve janë ato që do përcaktojnë tek e fundit si do të jetë edhe e ardhmja ekonomike, por vetëm edhe sociale dhe të gjitha zhvillimeve të tjera që neve kemi në qytetin e Durrësit.

Unë me thënë të drejtën nuk doja të hyja në shumë detaje duke pasur parasysh për të respektuar edhe pjesën e kohës. Do të bëja disa pyetje direkte që kanë lidhje me pjesën e buxhetit dhe do të doja që për secilën nga ato të kisha nga një përgjigje të veçantë. Unë do t'i bëj të gjitha, por nuk dua që asnjë nga ato pyetjet që neve do bëjmë të slitohet, meqënëse besoj që janë të rëndësishme. Atëherë pyetja e parë. Neve në buxhetin e vitit të kaluar në këtë këshill kemi kaluar tarifën e parkimit nëpër rrugët e qytetit dhe në parkimet publike. Pyetja ime është: Pse është neglizhuar kjo tarifë dhe nuk është mbledhur gjatë vitit 2025? Dhe a është parashikuar në buxhetin e vitit 2026 si pjesë e të ardhurave?

Pyetja tjetër, në vitin 2025 pati një ndryshim përsa i takon ligjit të mbledhjes së taksës të shfrytëzimit të rërës, pra të plazheve publike. Nga ana e bashkisë kemi një rezultat. Pra, ky vendim që u mor dhe që kaloi dhe në këshill, çfarë rezultati ka dhënë në buxhetin e bashkisë? Domethënë, veprimi dhe aprovimi që ne kemi bërë na rezulton pozitiv për arkën e bashkisë apo na rezulton negativ?

Në mënyrë që në këtë projektbuxhet që neve e kalojmë duhet ta marrim parasysh që, në qoftë se kjo është diçka që për industrinë e qytetit tonë është tek gjërat kryesore primare. Neve ta marrim parasysh dhe ta ndryshojmë. Në qoftë se ka dhënë rezultat është okej. Në qoftë se jo, atëherë duhet të kishim një raport për këtë punë që duhet të ishte pjesë e këtij projektbuxheti dhe automatikisht të marrim edhe përgjegjësitë kush e bëri në qoftë se është keq, por në qoftë se duhet ndryshuar të marrim dhe masat për ta ndryshuar.

Atëherë pyetja tjetër, problematikat e përmbytjeve. Më poshtë neve do të kalojmë një ndihmë përsa i takon të përmbyturve nga pjesa e shirave flasim. Në çdo vit neve kalojmë sasi monetare nga të ardhurat e bashkisë, që shkojnë në ndihmë të këtyre njerëzve, të cilët përmbyten. Ndërkohë nuk pashë në asnjë pjesë të programit dhe projektit për buxhetin një studim. Pra ne duhet shkojmë aty ku lind problemi. Në qoftë se nga ana e bashkisë neve nuk arrijmë, sepse nuk kemi specialistët e duhur atëherë t'i referohemi institucioneve vendore dhe ndërkombëtare për t'i dhënë një përgjigje njëherë e mirë këtij problemi në Durrës. Nuk mund të vijmë çdo vit dhe neve të aprovojme fonde dhe t'i shkaktojmë miliarda lekë dëme qytetarëve durrsakë, ndofta për problematika që i kemi shkaktuar ne, kur flas ne, i kemi shkaktuar pra i kemi shkaktuar i kanë shkaktuar njerëzit. Bllokimi i kanalit të ujërave të lartë, bllokimi i tubacioneve të ndryshme, të cilat shkojnë dhe shkarkojnë te terminalët kryesore. Mënyra se si kemi bërë përzgjedhjen e vendit për të ndërtuar hidrovorin e ri të qytetit dhe rezultatet e kësaj pune duhet të ishte pjesë e këtij studimi në mënyrë që, nuk është e vërtetë që me 10 minuta shi, gjys ore shi, një orë shi të krijohen ato problematika që neve kemi në zonën e plazhit dhe në zonën e ish Kënetës. Duhet të arrijmë thashë të planifikojmë një buxhet për një studim të mirëfilltë nga specialistë për të marrë një përgjigje definitive në mënyrë që në buxhetin e ardhshëm ndofta, të marrim masat që kjo problematikë mos ekzistoj më me qytetin e Durrësit.

Një pyetje përsa i takon projektit të “Rivitalizimit të TID”. Nuk mund të mbylлим sytë kur një grup qytetarësh janë në protestë aty poshtë bashkisë.

Joniada Musaraj: Zoti Muka.

Ardian Muka: Kam pesë pyetje gjithsej, domethënë deri tani kjo është e katërta. Në qoftë se do më jepni mundësi edhe për një pyetje....

Joniada Musaraj: Vetëm një diçka siç na kërkon të respektojmë procedurën dhe rregulloren e këshillit. Unë të ftoj ta respektosh dhe t'i përmbahesh asaj çfarë unë të kërkoja, që do të thotë ke komente, pyetjet i ke patjetër i parashtron. Për mendimin tim duhet të përqëndroresh tek buxheti që do të thotë të shikosh nëse ka vlerë për qytetin e Durrësit. Nga ana teknike shikoj që gabon në perceptimin që ke parë dhe i ke lexuar tabelat dhe së dyti doja që të jap mundësinë të lutem....

Ardian Muka: Për këtë do e prisja përgjigjen nga kryetarja e bashkisë.

Joniada Musaraj: Patjetër kryetares ja jap fjalën sa herë që e kërkon...

Ardian Muka: Nuk besoj i takon gjykimit tuaj nga ana teknike për të gjitha këto që unë po them janë të gjitha pjesë të buxhetit janë shqetësime të qytetarëve, të cilat thashë meqënëse këtu është kryetarja e bashkisë inprimis do kërkoja që ajo ta japi shpjegimin dhe ajo nuk po thotë që jo. Përsa i takon respektimit të kohës tashi kam dhe dy pyetje, këtë dhe një tjetër.

Joniada Musaraj: Të lutem për një herë të vetme do të kërkoja të mos bëje retorikë politike, që do të thotë të respektoni të gjithë këshillin dhe në lidhje dhe me atë shqetësimin tuaj që ju e keni për protestën jashtë, unë nuk besoj se ka lidhje me pikën që ne po parashtrojmë me buxhetin. Kështu që të lutem në respekt dhe të qytetarëve dhe të kolegëve tanë përmbaju asaj që unë të kërkoja dhe ja parashtrova gjithë anëtarëve. Kush ka komente në lidhje me buxhetin, të lutem respekto kohën sepse.....

Ardian Muka: Atëherë përsa i takon...

Joniada Musaraj: Do të ketë dhe komente nga kolegë të tjerë, mbylle sa më shkurt.

Ardian Muka: Përsa i takon protestës së atyre njerëzve që ka lidhje, ka lidhje që neve nuk mund të mbyllim dot sytë. Ka kontestime, ka shqetësime nga shumë banorë. Nuk është që është një, dy, tre, por tashmë ky është një fenomen që neve duhet t'i japim zgjidhje. Natyrisht duke filluar bashkia, por edhe këshilli duhet ta mendojë. Për këtë pjesë do të doja të dija nga ana e bashkisë si është menduar, sepse automatikisht moszgjidhja e këtij procesi ka lidhje me atë që neve nuk do të hapim dot procedurën e fillimit të procesit të rivitalizimit të zonës së TID , të projektit "TID". Prandaj i takon këtij këshilli, ndofta të jap sugjerime dhe bashkia nga ana tjetër, të shohim si ta gjejmë zgjidhjen, që këto qytetarë të kënaqen në ato çfarë janë kërkesat e tyre për mendimin tim legjitime dhe pjesa tjetër është që neve të fillojmë projektin e rivitalizimit të kësaj zone.

Për procesin e rindërtimit, natyrisht e kemi thënë që ky do ishte viti 2025 ai i përmbylljes së këtij procesi për shumë problematika objektive apo subjektive, nuk arritëm që ta përmbyllim. Nga komunikimet që kemi dhe me bashkinë, është thënë që do të bëhet një mbledhje e posaçme përfundimtare për të përcaktuar të gjithë ato çka do jenë procedurat që nga ana e bashkisë që do kalojmë pastaj në këshill, do kërkojnë prap aprovim nga këshilli të përmbyllet ky proces njëherë e mirë. Ndërkohë që e dimë godinat janë të gatshme aty ku do strehohen, pra propozimet që kemi për të të dëmtuarit nga ana e tërmetit. Do të doja nga ana e bashkisë një përgjigje që kur mendohet që ky proces të përmbyllet dhe çfarë është parashikuar natyrisht në buxhetin e 2026-s? Për aq sa kam lexuar unë kjo është e paqartë.

Pyetja e fundit përsa i takon situatës së mbetjeve, grumbullimit të mbetjeve dhe të Ujësjellësit. Atëhere e dimë që nga ana e bashkisë është firmosur dhe një kontratë tjetër 3 vjeçare me landfillin e Sharrës për depozitim të mbetjeve akoma në këtë landfill, kur landfilli ka problematikat e veta, të paktën nga ato që neve kemi arritur të perceptojmë nga ato çfarë janë lajmet për projeksionin e bashkisë në 2026, por meqënëse diskutojmë dhe deri në 2028. Kush do jetë dhe si mendojmë që ne zgjidhim problemin e grumbullimit dhe të trajtimit të mbetjeve?

Dhe përsa i takon pjesës së ujësjellësit. Pra ujësjellësi tani është pjesë e një agjencie, kërkon nga 2% një rritje 4% për pjesën e mbledhjes së detyrimeve që kalojnë nga kjo agjenci. Qytetarët janë

të paqartë dhe unë vetë me thënë të drejtën për kaq sa kam arritur të perceptoj, krijimi shkuarja nga bashkia si kompetencë e ujësjellësit, dalja në një ent rajonal, tani krijimi i një agjencie ka krijuar një konfuzion. Nga ana e bashkisë, në këtë rast kryetares, do të doja një sqarim kush do jetë strategjia pra për 2026, por në këto pikë edhe 2028 meqënëse po diskutojmë dhe për projektin afatmesëm të buxhetit?

Faleminderit, këto kisha.

Emirina Sako: Të tjera t'i grupojmë dhe..

Dritan Burgjia: Jo, ti bëjmë më mirë me radhë.

Emirina Sako: Ok atëherë tarifa e parkimit pse është neglizhuar? Ne e kemi vendosur në këshill në vitin, mbase fundit 2023-it viti ose 24-ës, kjo periudhë kohore, jo nuk ka qenë 23 ka qenë 24, kjo periudhë kohore ka qenë e nevojshme për të bërë gjithë procedurat përkatëse, sepse kemi dashur që parkimi mos të vendosi njerëz në terren që do japin biletën do marrin faturën por të bëhet elektronikisht, pra të bëhet nëpërmjet një mesazhi telefonik dhe është një kohë, e cila kemi dashur për të parë procedurën se si duhet të zgjedhim këto operatorë. Operatorët që janë në territorin e Republikës së Shqipërisë që operojnë me linja telefonike për të respektuar dhe ligjin e konkurrencës. Pra, kjo koha na është dashur për t'i identifikuar, për të negociuar me ta për tarifat, sepse operatori i cili do të marri mesazhin, pra në Vodafone apo One kushdo qoftë, do të mbajë një kuotë nga pagesa si kuotë shërbimi dhe kjo kohë ka qenë kohë e nevojshme për të kuptuar se si do ta menaxhojmë teknikisht këtë procedurë.

Ardian Muka: Po për 2026 si parashikohet?

Emirina Sako: Së dyti....., jo parashikohet një, po parashikohet ne kemi futur, unë e shpjegoja pak, kemi futur dhe një buxhet për vizimin, sepse nuk mundet të fillojë parkimi të operojë pa pasur sinjalistikën dhe duke qenë se na u desh kohë për të bërë këtë projekt, e vendosëm në buxhetin e 2026-s, do të prokurohet si zë i veçantë. Pra, nuk do të futet bashkë me gjithë sinjalistikën e ndërmarrjes, por do të jetë një zë, i cili do të jetë i dedikuar për rreth 4.000, mbi 4.000 parkingje që kanë rrugët, të cilët ne i kemi miratuar për këtu, do të bëhet vizimi, do të lihet një afat kohor që qytetarët ta kuptojnë mbase një muaj, një muaj e gjysëm, pra edhe pas vizimit një kohë për të respektuar këtë rregullore dhe më tej ne do të fillojmë tarifat. Kemi vendosur një propozim në plan, tek planet e taksave për 2026-ën dhe shpresojmë që do ta kapim, si domethënë mendojmë që do të duhet procedura e prokurimit për zgjedhjen e firmës për të bërë sinjalistikën, që do të dojë një 3 muaj sa të hapet thesari, sa të bëhet zëri në APP e tjera me radhë. Mendojmë nga qershori do jemi gati, domethënë për ta parë në terren.

Ardian Muka: Brënda 2026?

Emirina Sako: Kështu e kemi objektivin. Po unë e përmenda pak më parë po mbase s' ke pas vëmendjen maksimale. Tarifa e plazheve në këshill, ne vendosim, pra tarifat janë të vendosura të pandryshuara prej disa vitesh. Në këshill ne miratojmë hartën, mënyrën se si ndahet që do të thotë, normalisht përderisa ka pasur më shumë plazhe publike atëherë bie që edhe tarifa e vjelë

është më e ulët sesa po ta krahasojmë me vitin 2024 apo me vitin 2023. Konkretisht në 2024 e kemi faktin 121 milion lekë. Planin e 2025-ës e kemi 60 milion dhe faktin 11 mujor normalisht procedurat janë likuiduar është 86 milion. Kemi bërë planin për 2026 po 85 milionë. Dua të theksoj diçka, që ne ë këtë vit duam që të aplikojmë një model, i cili shpresojmë që do të funksionojë për të dhënë shërbim të një plazhi publik në zonën e Gjirit të Lalzit midis Fondit dhe Bashkisë së Durrësit. Pra do të duam të ngrijmë një strukturë të përbashkët, e cila do të operojë me modele të ndryshme plazhesh. Sigurisht që do ja propozojmë këshillit kur të vijë momenti që të jetë konkretizuar projekti dhe të ngrejmë një ndërmarrje, e cila mund të operojë për të kuptuar a na sjell, sa të ardhura i sjell bashkisë ky proces. Dhe në qoftë se do të ketë sukses mundet që ta shtrijmë edhe më gjerë jo vetëm në zonën e Gjirit të Lalëzit. Pra, tarifa në krahasimisht duke qenë se janë shtuar sipërfaqet si ndryshimi i VKM-së së plazheve, vjelja e tyre është ulur, por në bazë me parashikimin është më e lartë.

Problematikat e përmbytjeve unë i preka pak, pra ne kemi filluar procesin për hartimin e një projekti, kemi dhe një parashikim të përafërt pra nga projektet e mëparshme që kemi bërë dhe janë zonat që preken rruga, pra tek rrotonda e Durrësit të Ri, te rruga Vllazërimi pra ai është aksi ku ne kemi probleme. Rruga e stadiumit është rruga tek zjarrëfikësja dhe gjithë kjo figurë është ajo e cila do të merret në studim dhe realisht duam që ta buxhetojmë brenda vitit. Pra nëpërmjet një fondi emergjencash apo një ndryshimi të një zëri të caktuar që mendojmë që është më pak i rëndësishëm sesa ky projekt. Duam që edhe brenda vitit ta financojmë, sepse ju e dini që këto janë projekte që financohen kryesisht në periudhën e stinës së verës.

Ardian Muka: Domethënë ne flasim për studimin...

Emiriana Sako: Ne po bëjmë projektin. Projektin, pra studim....

Ardian Muka: Ka nevojë për studim paraprakisht.

Emiriana Sako: Besoj, shiko ne normalisht bashkë me ujësjellësin i dimë problematikat se ku janë. Pra i kemi evidentuar të paktën, sepse problematikat nuk evidentohen në kohë të thatë, por në periudhat që kemi pasur situatë të vështira në qytet, kemi bërë dhe identifikimin e tyre dhe sigurisht një studim dhe një projekt i detajuar mund ta nxjerri të saktë atë, sepse mund të ketë nevojë që rruga Vllazërimi, për shembull të hapet komplet nga e para dhe të vendoset tërësisht tubacion i ri, por këto duhet të na japi një preventiv dhe një studio me eksperiencë në këtë fushë, sepse bashkia nuk ka kompetencë me inxhinierat e vetë që ka, për të bërë këtë tipologji studimi. Praktakisht nuk është një projekt i vogël, por është një projekt, i cili prek gjithë pellgun e lagjes 17 të Durrësit dhe e kemi në plan, sepse nuk e kemi si zë në vete, por në 2025-ën kemi pasur një buxhet ku kishim marrëveshje kuadër 2 vjeçare për hartimin e projekteve dhe brenda kësaj marrëveshje do kërkojmë që të bëjmë këtë projekt të fitojmë kohë kështu edhe nga prokurimi e tjerë me radhë.

“TID”-i të gjithë ato që thatë ju qëndrojnë, do të thotë që ne jemi dakort, jemi dakort me pretendimin e qytetarëve, por ka një ligj në fuqi dhe këtu kemi institucion vendimmarrës, në zbatim të legjislacionit dhe ne kemi propozuar këshillit dhe kemi miratuar vlerat e shpronësimeve në bazë të ligjit në fuqi për shpronësimin. Ministri i Kulturës dhe i Turizmit ka qenë në interpelancë dhe ka thënë që banorët do shpronësohen me vlerën e tregut. Do të ishim edhe ata

do të ishin shumë të lumtur dhe ne si institucion, i kemi qytetarët tanë, do të ishim shumë në qoftë se kjo arrihet, por me legjislacionin që është në fuqi dhe me VKM-të që janë fuqi me të cilat ne kemi punuar dhe mbas atyre kemi ardhur këtu sigurisht dhe komisionet i kanë parë vlefshmërinë e tyre. Ne këto kompetenca kemi. Me banorët jemi takuar shpesh herë, i kemi ofruar si me thënë ato janë të grupmoshave të ndryshme, të përbërjeve të ndryshme familjare, i kemi propozuar, që të bëhen pjesë e programeve të strehimit në rast se kanë vullnetin për ta bërë këtë. Ato që janë në një moshë të caktuar që janë pensionistë për shembull, dhe sigurisht që duam që t'i i shqyrtojmë me këtë prioritet, sepse janë banorë të qytetit, por nga ana tjetër mendojmë që ky investim është një shans që ka qendra e qytetit të Durrësit dhe është një investim, të cilin ne do t'ia kërkojmë qeverisë për ta realizuar, pasi ka, preventivi ndahet në dy pjesë. AF-ja do të bëjë rikonstruksionin e objekteve ekzistuese dhe shëmbjet dhe rindërtimin që është një fazë e parë. Ndërsa ë faza e dytë, ajo që prek dhe objektet që është kryesisht rehabilitimi i gjithë infrastrukturës rrugore, hapësirave publike, është një fazë e cila nuk është financuar ende dhe ne do ta kërkojmë atë në Fondin Shqiptar të Zhvillimit ose në Ministrinë e Turizmit, domethënë kjo është. Sa i takon diskutimeve me qytetarët, jemi të hapur në çfarëdoli lloj kohe për t'i dëgjuar dhe e kemi bërë këtë gjë në fakt, por tashmë ata kërkojnë edhe e kanë kërkuar dhe në gjykatë të drejtën e tyre dhe pothuajse që të gjithë kanë filluar proceset gjyqësore dhe ne kemi qenë në dy apo tre seanca gjyqi me secilin prej tyre të grupuar apo edhe në mënyrë individuale.

Ardian Muka: Shqetësimi im në lidhje me këtë problematikë ka lidhje me atë që ata kërkojnë zgjidhje. Zgjidhja mund të ishte një ajo që është ofruar nga ana e bashkisë për tu trajtuar anën e strehimit social. Pjesë tjetër do ishte gjeni mundësi, tani me protesta, por natyrisht ato relativat private që kanë, kanë ardhur apo qoftë si grup social përtej problemit që kanë ngritur në atë çfarë ju ...

Joniada Musaraj : Muka nuk dëgjohesh thërrite mikrofonin.

Ardian Muka: Pra, po thoja që në trajtimin e problematikës së qytetarëve durrsakë, të cilët preken me shembje pra që shkojnë në shpronësim nga ana e projektit “TID”, do sugjerim që t'u gjenin të gjitha mënyrat, në mënyrë që këto njerëz të jenë të sistemuar dhe për këtë kryetarja referon që janë ofruar edhe pjesë të problematikës t'u trajtonin me anën e procedurave të strehimit social, por ka shumë mënyra të tjera të cilat mund të ndërhyhet.

Natyrisht nuk mjafton të nxjerrim ligjin përpara. Neve të gjithëve na intereson që qytetarët të marrin atë çfarë u takon. Natyrisht duke u ulur dhe duke i bindur dhe ata që kërkesat e tyre mos jenë kërkesa që nuk qëndrojnë, por besoj që në të drejtën e tyre të gjithë ato çfarë kërkojnë qëndrojnë. Dhe nga ana tjetër qyteti të përfitojë atë çfarë është projekti.

Humbja në kohë në trajtimin e këtyre problematikave, futja nëpër kanalet gjyqësore do bëjë atë që ky projekt nuk do fillojë të implementohet në bashkinë e Durrësit dhe thashë neve interesin e kemi, sepse e dimë se çfarë do të thotë revitalizimi i kësaj qendre do sjelli punësim, do sjelli turizëm, do sjelli zhvillim. Faleminderit.

Joniada Muaraj: Faleminderit zoti Muka.

Emiriana Sako: Nuk po i rikthehem, por në fund të fundit edhe aplikimi i programit të strehimit bëhet nëpërmjet vullnetit të gjithsecilit prej tyre. Ne e kemi dhënë si alternativë. Varet edhe sa e gjejnë veten te kjo zgjidhje qytetarët, të cilët preken.

Sa i takon programit të rindërtimit kemi ende disa ankesa të pashqyrtuara po them apo ankesat pra që kanë përfituar 2+1 apo dhe kërkojnë 3+1 apo anasjelltas kanë përfituar 1+1 dhe kërkojnë 2+1, janë një grup rastesh që duhen miratuar në këshill. Nuk i kemi kaluar në këtë mbledhje për mos shtuar, sepse rregullorja thotë që ka një numër të caktuar pikash dhe ne tashmë e kishim kaluar me këto propozimet që kemi sjellë. Mendojmë që në janar, do të jetë domethënë, një mbledhje, e cila le të themi do të kornizojë, do të finalizojë, sepse ky është një proces i cili ka dhe do të ketë edhe në të ardhmen ankesa nga ana e qytetarëve. Mund të ketë qytetarë që ankohen dhe ne nuk i kthejm dot përgjigje që nuk merr përgjigje se kemi mbyllur procesin në këshill. Por ka qytetarë që kanë hapur vendime gjyqësore e të tjera me radhë, por në parim mendojmë që do të jetë e nevojshme dhe një mbledhje për të bërë vendimin e familjeve, të cilat nuk kanë marrë çelësat akoma.

Situata e mbetjeve, kemi kontratë të rinovuar me landfillin e Sharrës mendojmë që, pra objektivi që kemi është ngritja e stacionit të transferimit, i cili do të na ulë kostot. Supozohet që në stacion transferimi fillon bëhet dhe diferencimi i mbetjeve, plastika, qelqi, të cilat mund të rishiten, mund të riciklohen e tjera me radhë. Këto janë modalitete që do t'i shohim në vijim, dhe këto objektivi kemi që është bërë një studim nga KfV-ja ku jep disa alternativa. Alternativa më e mirë është ajo e një ish repartit ushtarak që është në zonën e rrugës së vjetër të Ndroqit le të themi. Po në fillim të rrugës. Nuk është pronë e bashkisë, është pronë e Ministrisë së Mbrojtjes. Do t'i drejtohem në momentin që projekti është gati dhe i përfunduar, është gati për t'u financuar nga KfV-ja. Do t'i drejtohem ministrisë që t'ia kërkojmë si pronësi qoftë ne apo AKEM-i që të fillojë ndërtimi i stacionit transferimi. Mendojmë që kjo është një zgjidhje e mirë dhe kjo më tej do të na lëri dhe hapësirë për të filluar procesin e ndarjes në burim, i cili është një proces shumë i vështirë dhe do një angazhim shumë të madh dhe nga ana e qytetarëve, por e rëndësishme është që të fillojë ndërtimi i stacionit të transferimit për uljen e kostove.

Agjent ujësjellësi për një periudhë shumë të gjatë ka pasur një kontratë me bashkinë e Durrësit ku jep shërbimin, pra ne ngarkojmë tarifat tona, taksën popullatës apo gjithë detyrimet që kemi tek fatura e ujësjellësit. Për këtë i paguajmë 2% të kësaj vlere. Ujësjellësi ka bërë një analizë dhe mendon që duhet për arsye të investimeve që ka bërë dhe ngritjes së një sistemi të ri më efikas e tjera me radhë. E ka rritur këtë tarifë në të gjitha bashkitë, pra ka bërë propozimin, i ka kërkuar të gjitha bashkive ku operon. Ju drejtuam dhe OSHEE-së për ta përdorur si agjent, sepse OSHEE-ja ka një vjelje më të lartë të tarifës së energjisë, pra shkon mbi 95%. Por ata nuk e pranojnë të copëzuar. Pra, duan që ose të jenë të gjitha bashkitë bashkë ose sepse ngarkohet sistemi, po e themi kështu në mënyrë banale le të themi dhe automatikisht do të shkojmë tek riformulimi i marrëveshjes me Ujësjellësin. Kjo nuk është një taksë që i shkon qytetarëve. Kjo është një tarifë që ata na e marrin ne kur na i japim këtë shërbim. Pra, momentin që mbledhin 100 lekë ka qenë 2% pagesa më herët, tani do paguajmë 4% për dhënien e këtij shërbimi. Faleminderit.

Ardian Muka: Përsa i takon pjesës së grumbullimit të mbetjeve, ngritja e stacionit të grumbullimit me ç'kuptoj, interpretohet thjesht si një fazë tranzitore, por që do shkohet drejt këtij zhvillimi. Pra që do jetë preseleksionimi apo jo? Kjo besoj që duhet të jetë pjesë e një studimi të mirëfilltë dhe një strategjie të mirëfilltë. Bashkia e ka një strategji për trajtimin e mbetjeve, e cila

ka qenë deri në vitin 2030. Nuk e arrijë ta kuptojë që pse nuk është zbatuar ajo. Po kemi hyrë nga emergjenca në emergjencë. Fakt që kjo trajtohet prapë në një moment emergjence, më lë të dyshoj që neve nuk do kemi një zgjidhje përfundimtare, por thjesht do ecim për të mbyllur disa momente, gropa apo vështirësi që bashkia mund të gjendet. Përsa i takon pjesës së ujësjellësit, nuk jam dakort.....

Emiriana Sako: Nuk e thashë që është emergjencë. Nuk jemi në situatë emergjente.

Ardian Muka: Jo jo nuk jemi... Në këtë moment nuk jemi, por fakti që ne i kemi mbyllur një landfill dhe kemi bërë një kontratë me një ent okej shtetëror. Po dhe po neve nga ana e bashkisë së Durrësit shkojmë dhe e paguajmë këtë tarifë si frangu pulën. Tashi pa bërë pjesë politike, po du s'duam, du t'i themi ca fakte. Tek e fundit këtu jemi dhe njerëz politikë. Në mendimin tim thashë duhet të ndërtojmë një strategji të mirëfilltë. Pra, duhet të jetë ndofta edhe në aspekt nacional, por neve na dhemb Durrësi dhe për Durrësin do flasim. Do të ndërtojmë një strategji në kuadrin e ndryshimeve që neve kemi pas, për shumë problematika, kush do jetë e ardhmja e grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve në bashkinë e Durrësit. Kjo mund të ishte një tematikë për shqyrtim në mbledhjet e ardhshme që ne do bëjmë, por natyrisht strategjia do na propozohet nga ju. Ne mund të japim për atë çfarë kemi pjesë, për pjesën e ekspertizës. Natyrisht e keni gratis.

Joniada Musaraj: Faleminderit z. Muka.

Ardian Muka: Përsa i takon Ujësjellësit, nuk jam dakort që ato çfarë thotë kryetarja, pra që nuk paguajnë qytetarët tek e fundit, në qoftë se do paguajnë....

Emiriana Sako: Nuk thashë që se paguajnë .

Ardian Muka:nuk e paguajnë qytetarët nga 2% në 4% diferencën nuk do të shkojë dhe do inçidojë tek qytetarët atë, por është e bashkisë. Automatikisht kjo rritje bashkia ato të ardhura që neve kemi marrë mund t'i dërgonim për të kryer investime të ndryshme, do t'i çojmë për të përmbushur atë që është kërkesa e atij operatori, i cili do mbledhi fondet, të cilat nuk i mbledh dot bashkia, por i ka dhënë me delegim një agjencie të jashtme. Faleminderit.

Joniada Muaraj: Faleminderit zoti Muka.

Atëhere, komente të tjera ka?

Dritan Burgija: Ma hap pak mikrofonin.

Joniada Musaraj: Patjetër zoti Burgija... Po, po.

Dritan Burgija: Përshëndetje të gjithëve,

Tani, pa dashur t'i mbivendosem zotit Muka, që edhe të shfrytëzojmë kohën në mënyrën më të mirë të mundshme. Sa i përket projektit "TID" nuk mund të rrijmë dot sot pa e prekur, ndërkohë që banorët atje poshtë po interferojnë me megafon këtu. Deri në këtë pikë unë vura re edhe nga ana e bashkisë që ka një lloj buonsensi për t'i dhënë zgjidhje banorëve. Ata banorë janë banorë që

jetojnë në qendër të qytetit, në zonat më të mira të qytetit. Kryetarja e bashkisë na përmendi ligjin, por gjithsesi deri këtu ne kemi arritur me akte administrative dhe nëse do ketë vullnet për me bërë akte administrative, t'i trajtojmë ato njerëz me dinjitet, domethënë t'i rikthehem dhe njëherë nëse është e nevojshme.

Sa i përket buxhetit, prapë nuk do t'i mbivendosem atyre që tha zoti Muka, po unë kam evidentuar disa shifra këtu që në fakt merrini si në formë pyetje dhe nëse keni mundësi na jepni një përgjigje. Për vitin 2025 shpenzimet totale të bashkisë sipas kategorive ekonomike në mijë lekë. Në 2025 shpenzimi fillestar ka qenë parashikuar diku 5.5 miliard, është 5.5 miliard parashikimi. Janë shpenzuar 6.5, afërsisht 6.5 miliard, duke ditur këtu që kemi qenë dhe në vit elektoral. Do donim një përgjigje domethënë për çfarë janë shpenzuar këto diferencat?

Sa i përket projektet e investimeve ndërtim dhe rikonstruksion të rrugëve në njësitë administrative për vitin 2027-2028, 2026 nuk ka as, domethënë parashikim e ka 0 lekë. 2027-a 264 milion lekë. Ndërtim dhe rikonstruksioni i rrugëve të qytetit të vitit 2027-2028. 2026-a 0 lekë, 2027-a 298 milion lekë. Materiale për riparimin e rrugëve, shesheve dhe trotuareve 2027-2028. 2026-a 0 lekë 2027-a 70 milion lekë. Blerje pemë dekorative 2027-2028 2026 0 lekë, 2027-a 35 milion lekë. Rehabilitim kuartallesh 2027-2028, 2026-a 0 lekë 2027-a 175 milion lekë. Po i mbani shënim apo..? Rikualifikime sheshesh 2027-2028, 2026-a plani i 2026-s 0 lekë, 2027-a 110 milion lekë. Rehabilitim fasadash 2027-2028, 2026-a 0, 2027-a 75 milion lekë. Rikonstruksion rruga “Aleksandër Goga” Spitali, 2026-a 0, plani i 2027-s 297 milion lekë afërsisht. Duke qenë se ju referuat edhe kërkesave të qytetarëve. Kërkesat e qytetarëve kanë ardhur besoj për këto rehabilitime. Pse nuk janë parashikuar për 2026-n, por për 2027-n, që është vit elektoral?

Rikonstruksion rruga “Kasem Durrësi” 2026-a 0, 2027-a 60 milion lekë, vazhdojmë..

Kemi për strehimin social nga Bashkia Durrës. Kemi transferta për buxhetet familjare dhe individët 20 milion për 2026-n, 30 milion pak më shumë se 30 milion për 2027-n. Për rrjetin rrugor fola, këtu e kisha të përmbledhur. Shpenzime kapitale, 268 milion pak më shumë se 268 milion plani 2026-s , 314.5 milion 2027-a. Kemi fondin rezervë, niveli i shpenzimeve të paparashikuara kundrejt shpenzimeve vjetore të planifikuara në përqindje, 2026-a 0.98%, 2027-a rritet 1.3%

E kuptoni që po flas për vitin elektoral apo jo?

Pastaj vijmë në një tjetër gjë shumë e rëndësishme për promovimin e turizmit, 2026, 2027, 2028 0 lekë. Po flasim për një qytet si Durrësi, që është qytet turistik dhe mbahet me turizmin, me të ardhurat nga turizmi. Do ishte shumë e udhës që të kishim sa më shumë projekte, domethënë të kishim fonde për projekte që Durrësin ne ta kthejmë në qytet që vizitohet 12 muaj të vitit. Që të ndodhin të gjitha këto, që t'ia heqim 2026-s dhe t'ia japim 2027-s diku këto fonde dhe çfarë kemi bërë? Rendi dhe siguria publike 2026-a 305 milion, 2027-a 212 milion. Bujqësia, pyjet, peshkimi, gjuetia, 2026 198 milion gati 200, 2027-a 99 milion. S'kemi nevojë për rend dhe siguri publike në 2027? Nuk kemi nevojë për bujqësinë, për pyjet, për peshkimin, për gjuetinë ?

Menaxhimi i infrastrukturës, ujitjes dhe kullimit, 2026-a 183 milion, 2027-a 90 afërsisht 95 milion, domethënë janë hequr, janë reduktuar për 2027-n. Rrjeti rrugor rural është me rritje.

Joniada Musaraj: U kuptua ideja zoti Burgia.

U kuptua në rrjedhën llogjike që ju ndoqët për zërat.

Dritan Burgija: Urdhëro.?

Joniada Muaraj: U kuptua në rrjedhën llogjike që...

Dritan Burgija: Arritët t'i mbanit shënim se ishin disa..

Joniada Musaraj: Zëra ishin, kështu që ne kuptuam llogjikën.

Dritan Burgija: Ok. Në rregull.

Rolant Xhelilaj: Me leje ? Një koment apo me leje..? Hekuran do flasësh ti apo të flas unë?

Unë do ta filloj nga zoti Muka. Pyetjet e zotit Muka janë shqetësim normal, përputhen edhe me shqetësimet që kemi ne, por që në nisje që bëri rakordimin e buxhetit edhe në monedha të huaja, vërtetoj tezën që është një buxhet i hartuar shumë mirë. Edhe pyetjet ishin të gjitha të cilat i përkasin punës së bashkisë, por dhe qeverisë, për vitet në vazhdim. Kështu në këtë pikë jam dakort me komentet e zotit Muka. Kurse pjesa tjetër pastaj, tendenca për t'i dhënë ngjyrë politike është e drejtë e tij. Këtu punohet, fakti që punohet e tregojnë rezultatet, fakti që punohet e tregon edhe ajo rritje e shifrave të të ardhurave dhe shpenzimeve nga viti në vit.

Kurse te pjesa e zotit Burgija desha të theksoj diçka. Po të vish në komision i bën komentet si duhet dhe duhet kuptuar që ne sot, në fillim miratuam programin për buxhetin afatmesëm 2027-2029 dhe pikë të dytë të rëndësishme kemi miratimin e buxhetit për vitin 2026 dhe kur lexon ato shifra duket sikur çfarë ka ndodh. 2026 zero thotë 2027-a kaq vit elektoral, po 2028-a çfarë është..? Apo punohet vetëm në vite elektorale është një tezë që vetëm politikisht mund ta thuash. 2026 që miratohet sot ka projekte që kanë filluar në 2025 dhe vazhdojnë në 2026 dhe janë për zgjidhjen e shumë problemeve që ka qyteti, që ka komuniteti, që ka popullsia e Durrësit dhe e gjithë zonave përreth, që përfshihen në bashkinë e Durrësit. Kështu që edhe në qoftë se mund ta quajmë shqetësim normal nuk përputhet me realitetin ose tregon faktin që projektbuxheti 2026-s është i hartuar shumë mirë dhe për këtë pozicioni i tyre do të vërtetohet dhe me votën që do japin. Kurse gjithë komentet e tjera pastaj marrin ngjyrë politike të cilat nuk i shërbejnë as mbledhjes, as buxhetit, përmbi të gjitha as qytetarëve. Shqetësimi për çdo gjë që ndodh në qytet është te të gjithë ne, se ne jemi banorë të këtij qyteti, jetojmë këtu, por mundohemi që të jemi korrekt në përputhje me legjislacionet në fuqi dhe mundohemi të ndikojmë brenda legjislacioneve për përgjigje më të mirë, sa më të mirë për qytetarët. Kështu që unë, për të mos përsëritur dhe duke falenderuar kryetaren për prezantimin shumë dinjitoz pozitiv që i bëri buxheti vitin 2026, shpreh votën pro të buxhetit të grupit të Partisë Socialiste dhe ftoj dhe grupet e tjera ta votojnë këtë buxhet që është buxhet për qytetarët, nuk është buxhet për grupimet e veçanta. Faleminderit.

Joniada Musaraj: Faleminderit zoti Xhelilaj.

Të lutem një sekondë...

Po Burgija.

Dritan Burgija: Zoti Xhelilaj ka qejf t'i japi ngjyrimë politike, po këtu nuk.., ne në fakt vijmë si përfaqësues politik këtu, po gjithsesi nuk e kisha në atë sens. E kisha në sensin që qytetarët kanë nevojë për këto shërbime që nesër.., 2026-a është vit i rëndësishëm dhe nuk kemi pse i shtyjmë

punimet për 2027-n, pavarësisht që ju e përktheheni domethënë në politikë këtë që unë sapo thashë. Ne do ta deklarojmë votën kundër përgjithë sa foli zoti Muka dhe sa fola unë. Kështu që thirrjes....

Joniada Musaraj: Faleminderit zoti Burgia.

Hekuran të lutem vetëm një diçka. E udhës që sot flasin kryetarët e grupeve kështu që.

Gjithsesi ne hallin e tyre ne nuk e zgjidhim kështu që nuk na.., ne na intereson të respektojmë kryetarët kështu që..

Po, vazdo Markola.

Hekuran Markola : Vetëm të sqaroj zotin Burgija që ju referua PBA-së buxhetit të afatmesëm projektbuxhetit të afatmesëm gjatë gjithë kohës që foli, 2027 e ka pasur dhe vitin që kaloi, nuk është se dolën për herë të parë shifrat këtu dhe edhe 2026 edhe 2025 pastaj bëjnë krahasim me 2025 që realisht është plan akoma, nuk është faktik dhe krahasimet do të bëhen gjithmonë me 2024 dhe mendoj që, ato që tha të gjitha, shumica nuk qëndrojnë, për shkak se ju referua buxhetit afatmesëm, jo projektbuxhetit të 2026-s. Të ardhurat janë 65 milionë, po themi milion dollar, milion euro ose 65 miliard lekë të vjetra. Shpenzimet janë 65 miliard lekë të vjetra. Nuk kursehet dhe nuk devijohet asnjë gjë për vitin pasardhës, teorikisht të paktën. Faleminderit.

Joniada Musaraj: E ka kërkuar fjalën z.Nezha.

Luan Nezha: Përshëndetje.

Unë jam dakort me z.Muka dhe s'po i shtoj asgjë.

Unë kam një pyetje të drejtpërdrejtë për kryetarin e bashkisë. Një zë në buxhet është restaurimi i objekteve para 90-ës, ku janë dy periudha të ndryshme nga ana profesionale 1920 deri në 1940-n. Ka një projekt të saktë ose të mirëfillt? Sepse është buxheti i tretë që miratojmë dhe ne flasim për turizëm, zhvillim, zhvillim, zhvillim dhe ndoshta ka ardhur dhe momenti që Durrësi të ketë një projekt të qartë edhe me qeverinë qendrore për ta bërë sa më të saktë dhe sa më të ardhshëm për të ardhmen, që ne kur të ikim nga ky këshill, të jetë një projekt që të lejë gjurmë për zhvillimin e qytetit të Durrësit dhe për brezat më tej tek pjesa, sepse po të shikojmë, shikojmë buxhet mbetjesh 14% që është goxha e konsideruar dhe për disa zëra që janë shumë sensitiv dhe janë shumë të nevojshëm për Durrësin, i shikojmë me zëra shumë të vogla. Për shembull, po të shikojmë pjesën e 3% ishte vetëm e buxhetit të zjarëfikëseve e të tjerë dhe sikur është diçka që me realitetin dhe për të arritur efikasitet, e Durrësi të jetë një qytet i vizitum. Sepse flasim atë që tha dhe Burgija që bëhet fjalë që Durrësi të kthehet në 12 muaj të vizitueshme mos të jetë vetëm 90 ditë që kemi plazhin.

Dhe një pyetje tjetër ndoshta dhe ndoshta dhe mund të gaboje, po në dijeninë time dhe në disa email-e që më kanë ardhur në mënyrë të drejtpërdrejtë ka një diskriminim, po them që zona e Gjirit të Lalëzit dhe zonat atje, paguajnë më shumë për metër katror në sezonin e plazhit se qyteti. Nuk e kam 100%, po më është më është dërguar mesazh që ne pagojmë 3.000 lekë të vjetra për për metër katror në plazhin e zonat Gjirit të Lalëzit dhe në Durrës një. Këtë e kam nga email-et ose mesazhet që kam marrë ndoshta dhe mund ta kem të gabuar. Faleminderit.

Emiriana Sako: Kuptova qartë. Ti kishe për zërin e fasadave fillove që the.

Luan Nezha: Po

Emiriana Sako: Fasadat në përgjithësi ne çdo vit kemi marrë financim nga qeveria shqiptare nëpërmjet Fondit Shqiptar edhe jemi fokusuar tek objektet para 90-ës. Duke qenë se ka dhe një VKM që flet për amortizimin e këtyre objekteve. Kanë një moshë të caktuar, pra të cilat duhet të restaurohen. Ka qenë dhe një projekt që ka pasur një impakt të madh për të thënë të vërtetën, sepse kryesisht lagjja 18 dhe lagjja 16 janë dy lagje që janë në përgjithësi me objekte pesë, katër të ndërtuara para viteve 90 dhe aty impakti i investimit ka qenë më i lartë, sesa të investosh në objekte tek e tek. Këtë fondin që kemi vendosur nuk e kemi diferencuar në dy zëra para 90-ës apo pas, sepse mund të ketë dhe objekte të ndërtuara pas 90-s, të cilat kanë nevojë për ndërhyrje, por ne do tentojmë që të përdorim fondin e komunitetit aty. Pra mos të çojmë investimet tek objektet që janë pas viteve 90 dhe këtë zë do ta vazhdojmë tek projektet e mbetura të cilat, pra i kemi projektet gati, por kur kemi aplikuar kemi aplikuar total, për 50 objekte na kanë dhënë financim për 30 po them, po e sqaroj kështu në mënyrë të përgjithshme. Do vazhdojmë të aplikojmë rast pas rasti, në qoftë se ne Fondi na i miraton këto investime këto fonde do t'i kursejmë dhe do t'i çojmë me një destinacion tjetër domethënë, pak a shumë kjo është.

Pastaj çështja tjetër është pak e përgjithshme. Sigurisht ne punojmë çdo ditë për qytetin e Durrësit. Ju i konsideroni mbetjet si një zë si me thënë, mbase që është e lartë si vlerë apo që nuk ka ndonjë rëndësi të veçantë. Por më beso që, në qoftë se rrinë gjysëm ore pa hequr ato koshat, do jesh i pari që do marrësh celularin dhe do dalësh në facebook gjysëm ore, jo një ditë, dy ditë, tre ditë. E kupton? Kështu që..

Joniada Musaraj: Pa mikrofon.. Nezha je pa mikrofon.

Luan Nezha: Edhe diçka tjetër. Tani po ta shikojmë periudhën e verës, ka ditë që në rrugën Maminas-Gjiri Lalëzit që kap pjesa dhe rruga Sukth -Gjiri Lalëzit ka...

Të lutem, të lutem ta mbaroj dhe pastaj, e di se është e Shijakut, pastaj Manza dhe Gjiri Lalëzit, dhe po të shikojmë rrugën autostratë dhe Gjiri Lalëzit rrinë dhe katër-pesë ditë mbeturina në rrugë. Tani përgjegjësia kujt i bie qytetarëve apo e bashkisë?

Emiriana Sako: Jo jo. Po s'është bashkia Durrësit

Luan Nezha: Sukth, Gjiri Lalëzit, Rrushkull, Sukth -Rrushkull është, më vjen keq tani..

Emiriana Sako: Sukthi po është, Maminas-Gjiri Lalëzit po të përktheja..

Luan Nezha: Maminas-Gjiri Lalëzit është termologji që përdora nga rruga, se normale që në rrugë...

Emiriana Sako: Po jo edhe ajo që kalon Rrubjekën derisa arrin në qendër të Manzës ajo është një rrugë e cila menaxhohet nga bashkia Shijakut. Sigurisht që ne nuk po themi që nuk kemi pasur probleme në territor, sidomos në periudhën e pikut, periudha e verës është një periudhë, që ka një

ngarkesë të jashtëzakonshme. Mbetjet evadohen edhe në zona të caktuara tre apo katër herë me mjete të vogla, me mjete të mëdha dhe jemi në territor gjatë gjithë kohës. Në momentin që kemi pas problematika në rrugë të caktuara, kemi ndërhyer edhe me makineritë e dy ndërmarrjeve, se kemi dy ndërmarrje të ndara, me mjetet ndihmëse të tjetrës, por zona e Sukthit menaxhohet me sipërmarrje, pra ka një kontratë. Dhe në rastet që kemi pasur shqetësime, ne kemi mbajtur penalitete ndaj kompanisë.

Joniada Musaraj: Atëherë faleminderit.

Meqënëse komente të tjera nuk....

Denisa Luarasi : Ka kërkuar fjalën Kasa.

Joniada Musaraj: Kush e ka kërkuar?

Më fal Flutura se nuk të pashë.

Flutura Kasa: Atëherë si përfaqësuese e Partisë Socialdemokrate normalisht që e deklaroj votën pro. Vetëm kisha diçka të vogël për zotin Muka, me gjithë respektin e veçantë që kam për të. Momentin që foli për rindërtimin, dhe pyetja u bë pak me ironi dihet. Kam 6 vite e gjys, që jam pjesë e komisionit të strehimit dhe e di shumë mirë punën voluminoze, të jashtëzakonshme dhe dihet që bashkia e Durrësit ka qenë më e dëmtuara, por ne nuk mund t'i lëmë dot ato njerëz që e kanë ndjekur edhe në rrugë ligjore, kanë pasur edhe shumë probleme me dokumentacionin deri në momentet që i kanë rregulluar, dhe është e drejta bashkisë që të tregohet e kujdesshme për t'i pritur këto njerëz, deri në momentin që ato t'i kenë të kopësitëme të gjithë dokumentacionet. Kupton? Është diçka shumë delikate, sepse s'mund t'i lësh dot të tjerët pa shtëpi në një moment që ai ka një ngërç ligjor, deri në momentin që ta zgjidhi. Kaq kisha. Faleminderit.

Joniada Musaraj: Faleminderit zonja Kasa.

Atëherë zoti Muka nuk ishte thjesht një përgjigje e atyre që ju parashtuat më parë.

Dëgjo, ke të drejtë kur përmendet emri, është replikë, por në rastin konkret ishte thjesht një koment dhe ishte një vazhdim i një përgjigjeje që të dhanë dhe kolegë të tjerë. Kështu që...

E ke me merak? Patjetër..

Flutura Kasa: Dhe shkon gjatë pastaj kështu që më mirë lëre.

Ardian Muka: Ju falenderoj për konsideratën natyrisht zonjën Flutura sikurse dhe zotin Xhelili për atë pjesën e observacioneve, që bën për atë çfarë unë diskutova. Natyrisht besoj që kam shpreh thjesht problematika që kësaj mbledhje, por dhe ato çfarë janë për t'u trajtuar për të mirën e qytetit besoj që ishin të domosdoshme. Natyrisht përse i takon pjesës së rindërtimit, besoj që dhe ajo analiza që unë kërkoja të bëj dhe përgjigjja që u dha nga ana e kryetares së bashkisë, ka lidhje me shqetësimin qytetar që sa më shpejt kjo procedurë të përmbyllet. Dhe meqënëse në komunikimet që unë kam pas me pjesën e bashkisë, ku kam shprehë shqetësimet e qytetarëve si në mbledhje, por edhe jashtë mbledhjes, natyrisht është thënë që ky proces është në proces përmbyllje, i cili do u përmbyllte teorikisht brenda vitit. E kemi pyetur këtu në seanca edhe nënkryetarin, nënkryetarët që kanë qenë në përfaqësim, në mbledhjet e mëparshme, të cilët janë

shprehur që dikush thotë dhe brenda qershorit, dikush brenda dhjetorit, natyrisht pa përcaktuar vitin, por meqënëse jemi duke diskutuar buxhetin, thashë besoj që diskutimi im ishte konstruktiv dhe mori një përgjigje që brenda janarit të 2026 ta përcaktojmë tani, do kemi një mbledhje e cila do të jetë një mbledhje përmbyllëse, por natyrisht për problematika të tjera që mund të kenë, sepse thashë ajo çka ka ndodhur nuk është diçka normale. Flasim për forca mbinatyrore, ku neve kemi dhënë bashkëpunimin tonë 360° si opozitë në këshill, por jo vetëm, për të ndihmuar atë çka lidhje me kalimin sa më shpejt të kësaj problematike që ne patëm nga tërmeti. Thashë, besoj që kam qenë konstruktiv. Ju falenderoj për konsideratën.

Joniada Musaraj: Faleminderit.

Faleminderit zoti Muka.

Atëherë meqënëse nuk ka më komente unë propozoj që ta kalojmë në votim.

Ka folur.... Konesha ka folur kryetari.

Munir Konesha: Kërkoj fjalën.

Joniada Musaraj: Kërkoje mikrofonin.

Munir Konesha: Dua t'u tregoj dhe gjithë kolegëve kryesisht të opozitës. Po flasim më shumë për të ardhurat. Të ardhurat në bashkinë e Durrësit kanë ardhur gjithmonë duke u rritur pa pasur asnjë ndryshim në paketën fiskale. Në vitin 2022, e përmendi dhe kryetarja, kanë qenë të ardhurat e veta ato që grumbullon bashkia e Durrës rreth 15 milion euro. Në 23-shin kanë qenë rreth 18 milion euro dhe 24-n janë 23 milion euro. Pa arrit asnjë taksë janë grumbulluar dhe në pritshmëritë plani i vitit 2025 është rreth 26 milion euro dhe pretendohet shkohet 3.3 milion euro, çka tregon për një performancë të mirë të bashkisë në lidhje me të ardhurat. Dhe vijmë atje ku ngriti dhe shqetësimi zotit Muka për të ardhurat që marrim neve nga puna që bën ndërmarrja e ujësjellësit, në vitin 2024 ndërmarrja e ujësjellësit ka pasur një performancë të mirë në të ardhurat që derdh në bashki. Zoti Muka dhe nuk punon kush në kapitalizëm pa lekë.

Joniada Musaraj: Faleminderit, faleminderit zoti Konesha.

Munir Konesha: Tani prit o prit, ato fol gjysëm ore edhe s'u the njëherë faleminderit.

Atë që dua të përmendë, tjetrën unë, se ngriti zoti Muka, ai Burgija ngriti se qyteti i Durrësit..... Të lutem shumë..kështu qyteti i Durrësi....

Joniada Musaraj: Më konçiz, të lutem më konçiz sepse foli kryetari i grupit për...

Munir Konesha: nuk ka investime në rrugë dhe jemi planifikuar për kohën 2027. Nuk është e vërtetë. Vetëm, në qytetin e Durrës janë planifikuar 100 milion lekë të reja në rrugë dhe në Durrësin e ri 80 milion lekë të reja për herë të parë dhe gjej rastin ta përgëzoj kryetaren, por do t'i kërkoj një gjë. Mos ma cëno këtë fond në raport me realizimin e të ardhurave.

Joniada Musaraj: Atëherë faleminderit.

Unë propozoj që ta kalojmë.....

Dritan Burgjia: Më mirë mos kishe fol se ne folëm për të ardhurat.....Kur të ardhurat rriten....e di vetë si është qyteti.

Joniada Musaraj: Atëherë të nderuar kolegë mbas komenteve unë propozoj që ta hedhim në votim. Kush është pro pikës 2 të rendit të ditës?

Shiko se kanë ardhur dhe të tjerë dhe kush është shtuar...ok...

Kush është kundër...?

Faleminderit.

Boshku je kundër..?

Arlind Boshku : Kam qenë kundër gjithmonë.

Joniada Musaraj: Ndjesë se nuk të pashë dorën. Mendova se kishte ndaluar tabela, thjesht rastësisht.

Atëherë me 29 vota pro, 9 kundër, asnjë abstenim, kalohet dhe miratohet pika 2 e rendit të ditës.

Faleminderit.

Flutura Kasa : Suksese, ta gëzoni.

Joniada Musaraj: Atëherë në lidhje me **pikën 3** i jepet, fjala ishte parashikuar Komisionit Rregullores, Çështjes Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Në kushtet që jemi dhe meqenëse erdhi dhe e papritur unë isha përgatitur, kështu që e marr fjalën vetë të flas si kryetare e këtij komisioni.

Atëherë komisioni ynë propozon, që unë propozoj si kryetare të votohet kjo pikë e rendit të ditës me një ndryshim, dhe ndryshimi ka të bëjë pikërisht me tabelën 39. Lidhet me tarifat e kopshteve dhe çerdheve në të cilat nga bashkia Durrës është propozuar që të hiqet tarifa fikse të bëhet 0 lekë nga 360 lekë në muaj që ka qenë për fëmijë dhe është propozuar një rritje e këtij çmimi me 15 lekë që nga llogaritjet që është bërë nuk ndikon në xhepin e prindërve të fëmijëve. Kështu që përpos kësaj edhe pse nuk ndikon nga ana financiare te prindërit, unë propozoj që ne t'i qëndrojmë tarifave aktuale, që do të thotë tarifa e çerdheve të jetë 170 lekë dita për fëmijë, dhe ndjesë për kopshte të jetë 170 lekë dita për fëmijë dhe për çerdhe 165 lekë dita për fëmijë. Unë ju ftoj që ta miratoni. Taksa bëhet zero nga 360 lekë që ishte. Është gjë pozitive.

Prit, duroni duroni.

Atëhere ky ishte qëndrimi im si kryetare e komisionit.

Tani jap fjalën zoti Xhelilaj, kryetar i Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave, Tarifave.

Po. Po zoti Xhelilaj, qëndrimi juaj?

Rolant Xhelilaj: Edhe komisioni jonë. Madje duke pranuar edhe propozimin që erdhi nga Komisioni i Ligjeve për ndryshimin te tarifa e kopshteve dhe çerdheve, e kalon në Këshill Bashkiak paketën fiskale me idenë e miratimit në përputhje reale konkrete dhe me miratimin e buxhetit për vitin 2026.

Joniada Musaraj: Më vjen mirë që jemi dakort të dy komisionet.

Komente ka në lidhje me pikën 3?

Atëherë koment..?

Dritan Burgija : Po.

Ne deklarojmë votën kundër.

Joniada Musaraj: Atëhere kur të vijë pjesa e votimit, apo kërkon fjalën zoti Burgija?

Okej, okej, atëhere komente nuk ka.

Kalojmë në votim. Kush është pro?

Komente votim... Atëherë...

Munir Konesha: Kam unë, kam një propozim.

Këtu në këshill kryesisht me aplikimin e taksës në rrugë. Unë propozoj, më falni, që të bëjmë një ndryshim në pikën 2.5.2 me këtë përshkrim “Aplikimi i tarifës së parkimit në rrugë fillon në çdo rast me plotësimin e sinjalistikës dhe infrastrukturës nga bashkia.

Joniada Musaraj: Afroje pak të lutem, zoti Konesha.

Munir Konesha: Pra nëse nuk më dëgjuan po përsëris. Pra aplikimi i tarifës së parkimit në rrugë fillon në çdo rast me plotësimin e sinjalistikës dhe infrastrukturës nga bashkia. Pikë. Kryetari i bashkisë përcakton afatet e aplikimit për çdo rrugë ku do të aplikohet kjo tarifë, sepse ndoshta parkimi mund të fillojë kështu..... afat, afat, afatet. Unë kisha këtë propozim, pra që të jetë të plotësohet, sepse ne kemi përcaktuar në paketën fiskale kemi përcaktuar sikur ajo do zbatohet fakti qëndron ajo që thotë kryetarja e bashkisë, sepse nuk është i pamundshëm aplikimi i kësaj tarife. Ne e kemi në paketë, pra duhet të shtyjme këtë, duhet të përcaktojmë një përcaktim ligjor, që as administrata mos vihet përpara përgjegjësisë. Edhe...

Joniada Musaraj: Zoti Konesha duhet të ishte më i vëmendshëm. Kryetarja në përgjigjen që i dha zotit Muka e sqaroi dhe këtë pjesë kështu që, u sqarua që do i lihet dhe kohë që dhe qytetari.

Munir Konesha: Unë propozoj..

Joniada Musaraj: Patjetër patjetër, por sepse kjo gjë u sqarua. Kjo gjë u sqarua, dhe për më tepër që jemi te pika e 3.

Kështu që.... zoti Burgija....

Atëhere, unë propozoj ta hedhim në votim me ndryshimet.

Ndjesë.

Rolant Xhelilaj: U bë një propozim. Duam të dëgjojmë opinionin e kryetares së bashkisë.

Zë vënd, pranohet ?

Emiriana Sako: Se kuptoj.

Rolant Xhelilaj: Se kuptove.

Ta sqaroj pa pjesën e fundit që ta vendosi kryetari, se nuk e vendos kryetari më shok.

Emiriana Sako: Ti flet për tarifën. Tarifa përcaktohet në këshill.

Munir Konesha: Aplikimi ose kur të nisë kjo, e ke parasysh, të bëhet një ndryshim atje, të bëhet me plotësimin e sinjalistikës dhe infrastrukturës dhe kjo të lutem të jetë e shkruajtur. Një minutë të lutem shumë, pra të jetë ky përcaktim se kështu siç e keni juve pa përcaktuar e keni me...Urdhëro?

Emiriana Sako: O z. Konesha dëgjo. Paketa fiskale mund të rri dhe 10 vjet e pandryshuar, ne vendosim tarifa. Teknalogjitë e tjera se si bëhet vizimi afatet...

Munir Konesha: Dakord.

Emiriana Sako:vlerat, vendosen kur miratohet buxheti. E kemi vendosur dhe këtë në buxhet tani kur e prezantova unë besoj se e pe, që kemi thënë 12.8 milion janë vetëm për sinjalistikën e parkimeve do prokurohet, do fillojë.

Munir Konesha: Unë e kisha më shumë për të qenë edhe juve në gjithë procedurë kështu, si procedurë. Pra se kjo thotë, kjo paketë hy në fuqi menjëherë në fund.

Emiriana Sako: Po mirë. Po kur të bëhet sinjalistika çfarë do themi pastaj? Se ajo thotë kur të bëhet sinjalistika. U mbarua sinjalistika, kaloi dhe viti 2026, 2027. Çfarë do bësh me atë fjalinë sinjalistika aty?

Munir Konesha: E mora vesh pra. E mora vesh mirë.

Rolant Xhelilaj: Problemi është, problem për të sqaruar zotin Burgjia.

Propozimi i zotit Konesha është, mbaroni një rrugë me sinjalistikën të futet në tarifimin që bashkia të marri fonde nga rruga përkatëse.

Emiriana Sako: Ne do vijmë në këshill, kur të shtrohet rruga, kur të zgjerohet, kur të ndryshoj. Prandaj unë i thashë që nuk është kompetencë e kryetarit të bashkisë ajo që të nxjerri vendimin. Ndërsa për pjesën që propozon Joniada te paketa fiskale mendojmë që mund ta konsiderojmë, sepse të paktën opinionin im si drejtues i institucionit mund ta konsiderojmë, sepse nuk ka një peshë specifike të madhe dhe sigurisht mund ta quajmë si ulje të tarifës në këtë rast për regjistrimin e fëmijëve në çerdhe e në kopshte, faleminderit.

Joniada Musaraj: Atëherë faleminderit.

Të dy komisionet janë dakort e hedhim në votim.

Kush është pro për pikën 3 të rendit të ditës, me ndryshimet e propozuara?

Atëherë faleminderit, kush është kundër..?

Atëhere 9 kundër, po.

Abstenim ka?....

S'ka.

Me 28 vota pro dhe 9 kundër miratohet pika 3 e rendit ditës me ndryshimet e propozuara

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 4** Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Musaraj.

Atëhere në lidhje me pikën 4, komisioni ynë e miratoi me shumicën e votave të anëtarëve dhe ftojme këshillin sot që të japi votën pro.

I jepet fjala Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave -Tarifave zotit Xhelilaj.

Po.

Rolant Xhelilaj: Duke uruar që në periudhat që vijnë këto pasoja që na vijnë nga ndryshimet e rënda klimatike ose nga situatat që krijohen, të jenë sa më të pakta madje minimale dhe besoj në to ndikon dhe puna e kujdesshme që bëhet edhe nga bashkia, por edhe nga qeveria me ndryshime totale nga viti në vit, në përballimin e çdo lloj situatë që vjen. Komisioni jonë ia kalon këshillit për miratim dhe e mirëpret një vendim të tillë.

Joniada Musaraj: Faleminderit zoti Xhelilaj.

Ka komente në lidhjen me pikën 4?

Po zoti Muka.

Ardian Muka: Natyrisht siç e thashë edhe më parë ne jemi pozitiv për këtë. Pra, po miratojmë një fond, i cili i shkon në ndihmë të gjithë atyre qytetarëve durrsakë, të cilët janë dëmtuar nga kjo fatkeqësi natyrore që është përmbytja. Por siç e theksova dhe në pjesën e diskutimit që bëra për buxhetin, neve duhet t'i paraprimë problematikës dhe nuk duhet të kujtohemi që të zgjidhim situatat pasi ato na ndodhin. Sepse sado neve t'i shkojmë në ndihmë këtyre njerëzve, boll fakti që ato janë dëmtuar moralisht, psikologjikisht nga ato dëme që kanë pësuar, nuk ka lekë që arrin atyre t'i kthejë atë pjesë, qoftë dhe të dinjitetit njerëzor në shtëpinë e vet që janë të përmbytur.

Thënë këtë më rezulton dhe këtu rezervojmë të drejtën ndofta ngritje dhe të një komisioni hetimor sepse shumë persona, të paktën dy, ne i kemi evidentuar, por tashi do ta bëjmë kontrollin në tapet, janë persona, të cilët nuk janë prekur nga ana e këtyre përmbytjeve dhe ndërkohë kanë marrë njëri 4 milion e gjys lekë të vjetra, tjetri 9 milion lekë të vjetra. Janë njerëz me lidhje me pjesën e drejtuesve të njësive administrative. Të thash ky proces do kërkojë një farë analize nga ana jonë dhe për këtë besoj, që do kërkojmë ngritjen edhe të një komisioni hetimor nga ana e Këshillit Bashkiak. Faleminderit.

Joniada Musaraj: Faleminderit zoti Muka.

Atëherë komente të tjera nuk ka, e hedhim në votim.

Flutura Kasa : Ka si s'ka. Nëse i ke me emër nxirri me emër.

Joniada Musaraj: Prit, prit, prit. Prit të lutem...

Po, të është dhënë fjala z. Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Nuk kemi dëshirë që të japim opinion që po tha pala tjetër një gjë, ne të themi të kundërtën, por në qoftë se zoti Muka don informacion, e nisim që nga viti 2013 me ardhjen tonë në pushtet dhe me përmbytjet e para. Përmbytje të cilat sot janë në nivel minimal për një arsye të vetme, kujdesin e madh nga qeveria, por dhe nga bashkia për përmirësimin e situatës në ato zona që ishin lënë për faqe të zezë.

Kurse për pjesën tjetër pastaj komisioni hetimor është një çik si lojë fjalësh dhe për të tërheq vëmendjen edhe të këshillit, por dhe më shumë se këshilli, të shtypit. Në qoftë se i ke ato dy emra çoi në prokurori o shok, bashkë me kryetarin e njësisë. S'përbën asnjë lloj problemi për ne dhe ne s' marrim përsipër të merremi me një komision hetimor për një gjë gjë, që ju e keni zbuluar, i dini, janë emrat, çoheni dhe çdokush merr përgjigjen që i takon për veprime, të cilat nuk përputhen me ligjin. Faleminderit.

Joniada Musaraj: Faleminderit zoti Xhelilaj.

Ka komente të tjera? Jo.

Atëherë e kalojmë në votim.

Zoti Muka, më thuaj. Po e kalojmë në votim.

Tani të lutem, nëse ke në lidhje me pikën 3. Nuk besoj se është kthim përgjigje zoti Xhelilaj personalisht. sepse komentet i bëre. Pikën 4, ndjesë.

E ke gati mikrofonin z. Muka.

Ardian Muka: Po zoti Xhelilaj mund mos presi përgjigje, por fakti, unë e thashë neve kemi kërkuar edhe më parë komisione hetimore. Natyrisht ju me forcën e kartonit mund të bëni që asnjë komision hetimor këtu të mos ngrihet, por opozita do ketë forcën, kurajon, besimin, që ato gjëra që neve do të arrijmë t'i nxjerrim, qoftë me komision, por qoftë dhe pa komision, do t'i bëjmë edhe publike, do t'i çojmë edhe në prokurori. Faleminderit.

Joniada Musaraj: Faleminderit.

Tani të lutem t'ju shikoj të gjithëve, nuk ka komente.

Ta kalojmë në votim?

Kush është pro pikës 4, të rendit i ditës?

36. Faleminderit.

Kush është kundër? ... S'ka

Abstenim?Nuk ka.

Atëhere me 36 vota pro kalon pika 4 e rendi i ditës. Shumë faleminderit.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 5** Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Musaraj.

Komisioni ynë vendosi me shumicë votash ta kalojë pikën 5 për miratim dhe dhënien e votës pro nga ana juaj, nga ana e këshillit.

I jepet fjala Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës, zonjës Jonada Mamo.

Jonada Mamo: Përsëndetje, faleminderit,

Edhe komisioni jonë e miraton në unanimitet dhe propozon këshillit për miratim sot. Faleminderit.

Joniada Musaraj: Shumë faleminderit.

I jepet fjala komisionit të Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor, zotit Hekuran Markola. Po zoti Markola.

Hekuran Markola: Faleminderit kryetare.

Edhe komisioni i pronve publike i kalon për votim në këshillin bashkiak në unanimitet.

Joniada Musaraj: Shumë faleminderit.

Ka komente në lidhje me pikën 5?

Komente nuk ka. E kalojmë në votim.

Vota pro..?

Okej. Atëhere kundra s'ka, abstenim nuk ka.

Me 36 vota pro. Miratohet pika 5 e rendit të ditës. Shumë faleminderit.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 6** Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit zotit Florian Tahiri. Po zoti Tahiri.

Florian Tahiri: Atëherë komisioni jonë u mbledh dhe si gjithmonë përse i përket pjesës së ndihmës ekonomike e kemi miratuar dhe e kemi hedhur në votim.

Joniada Musaraj: Shumë faleminderit.

Ka komente në lidhje me pikën 6 të rendit të ditës?

Komente nuk ka. E kalojmë në votim...

Vota pro..?

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro kalon pika 6 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 7** Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Musaraj.

Atëherë në lidhje me pikën 7 komisioni ynë po sërish me shumicë votash e miratoi pikën 7 dhe fton këshillin që të japi votën pro.

I jepet fjala Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonjës Marsida Feshti.

Marsida Feshti: Përshëndetje, faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort të kalojë për votim në këshill.

Joniada Musaraj: Faleminderit zonja Feshti.

Komente ka në lidhje me pikën 7 ?

Komente nuk ka. E kalojmë në votim.

Vota pro...? 36 vota pro.

Kundër s'ka, abstenim nuk ka.

Atëherë kalon pika 7 e rendit të ditës, miratohet me 36 vota pro. Faleminderit.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 8** Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Atëherë në lidhje me pikën 8, komisioni ynë sërish me shumicë votash e miratoi dhe fton këshillin të japi votën pro.

I jepet fjala Komisionit të Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës, zonjës Jonada Mamo.

Jonada Mamo: Edhe për pikën 8, me shumicë këtë rast, pas gjatë diskutimeve dhe të gjitha pyetjeve që morën përgjigje nga administrata e bashkisë, e miratuam dhe ftojmë dhe propozojmë dhe këshillin ta miratojë.

Joniada Musaraj: Faleminderit zonja Mamo.

I jepet fjala Komisionit të Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor, zotit Hekuran Markola. Po zoti Markola.

Hekuran Markola: Faleminderit.

Edhe komisioni jonë e kalon me shumicë votash për miratim në Këshillin Bashkiak. E vetmja pikëpyetje që u ngrit aty ishte se ku është mali në Durrës ngaqë ka emrin paketa maleve.

Joniada Musaraj: Atëherë u miratua. Është miratuar, në rregull.

I jepet fjala Komisionit të Politikave të Zhvillimit të Turizmit zonjës Alketa Ngjeçi.

Të lutem kërkoje fjalën...

Po zonja Ngjeçi.

Alketa Ngjeçi: Përshëndetje.

Edhe komisioni jonë ra dakord që të kalohet në votim.

Joniada Musaraj: Shumë faleminderit.

Komente ka në lidhje me pikën 8 të rendit të ditës?

Llesh Çuni: Kam unë.

Joniada Musaraj: Atëhere i jepet fjala zotit Lleshi.

Po

Llesh Çuni: Atëherë unë me datë 15 dhjetor kam ndjekur personalisht dëgjuesën publike organizuar nga stafi i bashkisë Durrës në njësinë e Manzës. U ngritën mjaft probleme lidhur me caktimin e zonave prioritare për zhvillim, në kuadrin e paketës së maleve apo ligjit 20/2025.

Unë jam pro caktimit të zonave prioritare në territorin e Manzës. Edhe pse Manza nuk ka asnjë mal, është thjesht fusha dhe kodra, por eksperiencia e zhvillimit të kësaj zone disa vjeçare me agroturizëm “Huqi” që frekuentohet jo vetëm nga banorët e zonës të Durrësit e Tiranës, por edhe më gjerë se kaq, edhe nga turistë të huaj deri nga Australia e largët, Kanadaja, Zvicra, Turqia e me radhë. Pra nuk mungon eksperiencia në këtë drejtim, por marr shkas për këtë fjalë që po mbaj këtu para këshillit bashkiak, i ndikuar nga banorët e fshatit Armath. Aty ka aplikuar një zotëri me emrin Nexhmedin Beluli dhe për një sipërfaqe jo të vogël, por 13.5 hektar. Unë jam vetë banor i atij fshati Armath. Ajo është lënë nga Komisioni i Ndarjes së Tokave në vitin 1991 për t'u përdorur nga banorët e fshatit për kullotë dhe është ndarë nga 400 m² për frymë. Nuk e kanë marrë në tapi ose AMTP, për faktin e thjeshtë sepse po të merrnin atë pjesë kodrinore do t'u pakësohesh sipërfaqja në zonën fushore. Me mirëkuptim e kanë mbrojtur me fanatizëm, sepse aty s'do kishte

jo dru lisi, po asnjë lloj shkurre, po e ka mbrojtur secili pjesën e vetë. Tani tek ligji që citova më sipër 20/2025 për ironi të fatit të këtij zotërisë që kërkon ta marrë atë sipërfaqe për ullinj, madje thotë shpreh dhe interes për të ngritur ca shtëpi të vogla. Ai në nenin 3 dhe nenin 6 të këtij ligji, për koinçidencë pika c, e të dy neneve thotë: “Banori posedues, jo pronar duhet ta zotërojë atë më shumë se 10 vjet duke u sjellë si pronar i vërtetë i saj, çka nënkupton që ai të mos ketë asnjë lloj konflikti me banorët, pra duke u sjellë si pronar i saj. Edhe te neni 6 pika c, thotë: “Duhet marrë mirëkuptimin e banorëve para se sa të aplikojë”.

Për fat të keq zotëria jo vetëm nuk merr dot miratimin e banorëve dhe nuk është posedues siç thotë tek projekti, por unë kam këtu një dokument ta kthej para kamerave se këtu unë duhet të jem zëri i banorëve të Manzës. Është me firmë të gjashtë-shtatë fiseve që nuk lejojnë të tjetërsohet. Të qëndrojnë pronë shtet dhe ata ta shfrytëzojnë vetë.

Aty është dhe një krua mbi 200 vjeçar që zotëria posedon një sipërfaqe të vogël, e ka mbjellë me ullinj pa qenë fare banor në atë kohë. Po s'ka problem. Unë personalisht dyshoj që është marrë në rrugë abuzive dhe pronësia e asaj sipërfaqeje, sepse ai banon në Tiranë. Ka ndërtuar një shtëpi aty te ullit. Po tani fjala është se është e pamundur 13.5 hektar ta zhvillojë ashtu siç e ka paraqitur në projekt. Frika është që aty të vijë një banor tjetër dhe ta përdori si kullotë bagëtish nën fasadën e mbjelljes së ullinjve.

Unë, nëse zotëria është duke më ndjekur tani nuk e di. Ai s'ka pse të ketë qejf mbetje fare nga fjala ime këtu në Këshillin Bashkiak, por i sugjeroj nëse kërkon të aplikojë vërtetë për atë sipërfaqe të ulet këmbëkryq me banorët e fshatit Armath, të marrë mirëkuptimin e tyre edhe pastaj ta zhvillojë atë, si ta ketë planifikuar në kërkesën e tij. Kaq kisha.

Joniada Musaraj: Faleminderit zoti Çuni.

Atëherë komente të tjera ka?

Po zoti Muka.

Ardian Muka: Në mbështetje edhe të kolegut Çuni për fjalën e tij që tha, realisht ai ngren një problem që ligji në 20/2025 e ka në origjinë dhe nuk arrij ta kuptojë realisht se si ka kaluar. Megjithatë jemi përballë faktit. Atëherë ne na kërkohet miratimin e shpalljes së zonave prioritare të zhvillimit duke u bazuar në paketën e maleve.

Atëhere paketa e maleve, ligji e fillon dhe shumë i qartë. Ky ligj ka për qëllim tërheqjen e investimeve në nenin 1, nxitjen e zhvillimit ekonomik apo turistik të zonët me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore. Neve flasim për tre zona, të paktën ato ku janë bërë dëgjuesat publike, por që realisht janë dhe zonat me potencial zhvillimi. Flasim për zonën e Ishmit, zonën e Rashbullit dhe për zonën e Manzës. Në konceptin tim të paktën, unë jam brez i vjetër dhe kemi mësuar gjeografi, u thoshte në atë kohë që malet fillojnë nga 600 m dhe ikin derisa mund shkojnë. Në konceptimin e konventave europiane. Mali, unë kam nxjerrë një pasazh, një pjesë thotë është një reliev me një lartësi më shumë se 600 m nga niveli i detit. Pra, në qoftë se neve po kërkojmë që nëpërmjet këtij ligji, pra 20/2025 ta kalojmë si paketë malesh, neve jemi nga ana formale gabim dhe kjo natyrisht unë sugjeroj që edhe kolegët e pozitës me përfaqësuesit e tyre këtu në bashki, t'i vejnë realisht gishtin kokës të ulen me këmbë në tokë, sepse po bëjmë shkelje ligjore. Paketa e maleve, në qoftë se do na vijë e propozuar si paketa e maleve, kodrave dhe bregdetit, mund të bëhet edhe e aplikueshme dhe për qytetin e Durrësit, për bashkinë e Durrësit, sepse bashkia e Manzës është 30 m nga lartësia e detit pika më e lartë, Rrushbulli 10 m, Ishmi 89 m.

Asnjëra prej këtyre nuk arrin të futet. Asnjëra prej këtyre. Unë jam referuar me thënë të drejtën wikipedias, e cila wikipedia është ajo çfarë është e shkruar në të gjitha organizmat shtetërorë, referues për këto fakte. Pra, nuk është rasti i qytetit tonë që të përfshihet në paketën e maleve. Natyrisht ato persona, të cilët kanë aplikuar sepse është hapur kjo si si fushatë aplikimi, kanë shumë mundësi të tjera nëpërmjet AZHBR-së, nëpërmjet hipardit, nëpërmjet fondeve të tjera, të cilët mund të kërkojnë dhe të bëjnë aplikimin e tyre në qoftë se duan të zhvillojnë investimin, por këtu truku qëndron diku tjetër. Dhe jemi këtu për t'ia thënë qytetarëve durrsak, meqënëse ky këshill, secili prej ne nesh është në radhë të parë për të ruajtur të drejtën, për të ruajtur pronësinë e asaj çfarë është bashkia e Durrësit. Ligji 20/2025 në pikën c, është i qartë. Thotë më fal në nënenin 3 pika c thotë: "Poseduesi jo pronar është individ, personi fizik, juridik i identifikuar gjatë zbatimit të dispozitës të këtij ligji i cili ushtron, i cili ka ushtruar dhe ushtron posedim të vazhdueshëm dhe të pandërprerë për të paktën 10 vjet mbi pasurinë e paluajtshme shtetërore duke përdorur atë sikur të ishte pronari i saj. Për qëllime të këtij ligji konsiderohen posedues jo pronarë dhe ata individë që nuk e përdorin pasurinë, por vërtetojnë lidhjen e tyre me pasurinë për të cilën nuk janë pajisur me titull pronësie sipas legjislacionit fuqi dhe kërkojnë ta zhvillojnë atë nëpërmjet një investimi".

Atëherë, ajo çfarë do të thojë, është shumë e qartë. Pra, ky ligj i jep të drejtën poseduesve jo pronarë ta marrin të drejtën e pronës. Ato pajisen me çertifikatë pronësie, kanë të drejtë ta shesin dhe paguajnë për gjithë sipërfaqen vetëm 1€. Unë e kërkoja dhe një relacion në mbledhjen e komisionit. Kërkoja dy në fakt, kërkoja relacionin e parë për sa i takon të gjithë atyre personave që kanë aplikuar dhe aty ka kërkesa për sipërfaqe 1.000 hektar, ka kërkesa për sipërfaqe 500 hektarë, ka kërkesa për sipërfaqe 100 hektarë, 300 hektar. Dhe po të shohësh ajo çfarë është pjesa e shpjegimit është shumë e thjeshtë do ndërtojë një agroturizëm apo një restorant.

Në konceptin tim, po që duhet të jetë dhe koncepti i gjithë ne, është jemi këtu për të ruajtur atë çfarë është publike, duke i hapur rrugë këtij propozimi që neve na vjen për miratimin e shpalljes zonë për prioritare, u tha nga ana e bashkisë që neve çfarë po bëjmë tek e fundit thjesht hapim rrugën pastaj këto do kalojnë nëpër filtra dhe ato filtra do t'i bëjnë, do t'i përjashtojnë në qoftë se nuk plotësohen kriteret. Unë kisha një pyetje e ngrejta edhe në komision : Sa janë personat posedues jo pronarë në bashkinë e Durrësit, të cilët kanë marrë të drejtën e shfrytëzimit të tokave publike, toka bujqësore dhe jo bujqësore? Për të kuptuar që këto persona, sepse në ligj është shumë e qartë ti kur merr aplikon, ke një plan biznesi dhe në harkun e iks (x) kohe sipas plan biznesit ti duhet ta vësh atë tokë, që ke marrë në dispozicion nga ana e bashkisë apo nga shteti duhet ta vesh në funksion të komunitetit. Pra duhet të krijosh investimin, në mënyrë që të krijosh punësim dhe të krijon të ardhura të mira materiale. Ky është koncepti dhe ky është shpirti i ligjit. Në qoftë se ne po bëjmë një ligj dhe duam ta provojmë për të kënaqur disa persona oligarkë apo jo, patronazhistë apo jo, njerëz lidhur me pushtetin apo jo. Kemi eksperiencë të këqija. Kemi eksperiencë të këqija dhe shumë të këqija edhe në bashkinë e Durrësit, ku po na dalin persona të lidhur me organizata të ndryshme, persona të lidhur me krimin, të cilët kanë tjetërsuar prona publike. Nuk jua sugjeroj shumë përzemërsisht kolegëve dhe ju këshilloj, meqënëse është dhe pjesë e profesionit nga vijë, nuk është ky ligji që na duhet. Në qoftë se do ndryshojë si në formulim, pra nuk është paketë malesh që e prek Durrësin dhe këtu jemi besoj dakord të gjithë. Pjesa tjetër, mënyra se si formulohet, ju garantoj që në qoftë se do bëhet një analizë nga ana e bashkisë dhe neve dhe në këtë rast do kërkojmë të ngrejmë një komision hetimor nga ana e këshillit bashkiak për të kuptuar sa janë persona, të cilët kanë marrë persona posedues jo pronarë,

kanë marrë toka nga bashkia e Durrësit, nga qarku i Durrësit dhe sa prej tyre i kanë kryer të gjitha atë pjesë të financimit dhe të investimit në mënyrë që të jenë sot e kësaj dite ta gëzojnë këtë pronë. Ndryshe kush ka difektin, sepse besoj që janë mbi 90% në difekt, që e kanë marrë ato toka nuk i shfrytëzojnë thjesht i kanë në përdorim në pritje të këtij akti që neve po na propozoni për të kaluar ta marrin ta bëjnë pronë të tyre për 1€, ndërkohë që të gjithë e dimë kush do të shkojë të blejë një sipërfaqe toke në këto zona do shkojë ta paguajë 8, 10, 20 apo 30€ m².

Japim votën tonë, e deklarojmë votën tonë kundra këtij propozimi, që vjen për motivet e mësipërme dhe sugjeroj që është në lartësinë e këtij këshilli që neve mos ta kalojmë kështu siç na vjen i propozuar. Në qoftë se do ndryshojë ligji si në përkufizim, por edhe në përmbajtje ta shqyrtojmë dhe të vendosim. Faleminderit.

Joniada Musaraj: Faleminderit zoti Muka.

Atëherë kemi fatin e mirë që të dy jemi ekspertë në fushën tonë. Zoti Muka dhe unë po ju kthej përgjigjen në lidhje me shqetësimin nga ana juridike që ju keni.

Së pari Këshilli Bashkiak nuk merret me një ligj për të parë nëse është kushtetues apo jo, nëse do zbatohet apo jo. Ligji zbatohet dhe pika që ne po diskutojmë sot është faza e parë. Kështu që dhe pretendimet që ju keni në lidhje me faktin që koncepti që ju gjeni person jo pronar posedues është një koncept që nuk e shikon për herë të parë në ligjin që ju cituat. Është një koncept që është tek ligji civil dhe ka lidhje me parashkrimin fitues. Kështu që parashkrimi fitues është një mënyrë legjitime e fitimit të pronësisë dhe elementët që parashikon ligji i miratuar në Kuvend, i ka të gjithë elementët e ligjit civil dhe të parashkrimit fitues që ne si jurist e njohim si koncept.

Në lidhje pastaj me pjesën tjetër që ju pretendoni dhe bëni retorikë patjetër politike, sepse jeni dhe për këtë arsye këtu që këto toka përfitohen nga persona jo të ndershëm. Unë nuk di çfarë emërtimi t'i vë, sepse unë nuk njoh të tillë të them të drejtën. Kjo që ju thoni që qytetarit i jepet mundësia me mjete të tjera nuk e zhbën atë që ne po mundohemi t'i japim qytetarit dhe këtë mundësi tjetër. Kështu që nëse qytetari merr fonde të AZHBR-ja apo në një mënyrë tjetër kjo nuk do të thotë që ne si këshill t'i heqim mundësinë t'i ofrojmë dhe një shtesë apo një element të tretë qytetarit. Kjo për sa i përket pjesës nga ana ime si juriste.

Nëse ka komente të tjera.

Po..Po... Zoti Xhelilaj. Po

Rolant Xhelilaj: Po në përgjithësi unë jam dakord me shpjegimin tuaj, nuk e kundërshtoj pjesën e Mukës nga pikëpamja formale se thotë paketa e maleve Durrësi s'ka male. Po paketa e maleve është titull, kurse gjithë pjesa pastaj që trajton ajo paketë duhet ulur, duhet parë dhe shihet nga specialistët duke filluar nga parlamenti që miraton ligjin, por edhe nga strukturat poshtë pastaj deri në marrjen rrugë të zgjidhjes së problemit, apo të asaj që ky ligj krijon mundësi për banorë, investitorë pa emra, se patronazhist për Mukën është emër i mirë se patronazhist është dhe Muka. Megjithatë pak rëndësi ka kjo pjesë. Unë kam një merak te shoku im Llesh Çuni, sepse është zonë që unë e njoh mirë dhe vite përpara e kam mbuluar. Ka mundësi ndonjë përgjigje sot për problemin që ngren Lleshi të dëgjojmë këtë përgjigjen, dhe në raport edhe me këtë përgjigje të mendojmë mënyrën e votimit, por ritheksoj që ato zona kanë nevojë për zhvillim e pranoj unë edhe të gjithë të tjerët. Pastaj si na detyron pozicioni politik është gjë tjetër, por Çizmëlia, ku di unë, Armathi, të gjitha ato zonat andej kanë nevojë për zhvillim dhe s'ka më mirë kur kjo paketë ju jep mundësi ta zhvillojnë ata njerëz që posedojnë pronën atje. Janë ca pika që unë i dëgjova me

vëmendje dhe nga zoti Muka, që e kanë 10 vjet në përdorim, por e kanë, por nuk e kanë përdorur. Si do veprohet, të na jepet një shpjegim nga bashkia.

Joniada Musaraj: Po, ftoj Drejtoreshën ligjore të bashkisë të na shpjegoj.

Alneida Rroshi (Drejtoresha): Përshëndetje.

Këtë unë e sqarova dhe në komision, por duhet ta bëj këtë sqarim për gjithë këshilltarët që jemi Paketa e maleve, bazuar në ligjin 20/2025, paketa e maleve është titull. Ajo të cilit ne i jemi referuar se në të gjithë bashkitë e Shqipërisë është hapur një sistem ku është shprehur interes sipas ligjit 20/2025. Në bashkinë Durrës aktualisht janë më shumë se 127 aplikime ku ne jemi referuar sigurisht bazuar në ligjin, nenin 3 pika ç) “Zonë me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore” (në vijim zonë zhvillimi) është zona e miratuar sipas këtij ligji, e cila për shkak të karakteristikave që ofron peizazhi, burimet natyrore, trashëgimia kulturore apo tërësisë së aktiviteteve në natyrë që ofrojnë.....etjerë”. Megjithatë ajo çka për mua është më e rëndësishme që ne e kemi hasur dhe në dëgjuesat publike që ne kemi bërë, është pikërisht fakti i titujt të pronarve.

Ajo çka më kërkua në mbledhjen e komisionit është lista e atyre që kanë aplikuar dhe une jua kam dhënë këtë informacion. Ndërsa përsa i përket listës të poseiduesve dhe jo pronar, nuk mundet që këtë informacion ta ketë vetëm bashkia, pasi titulli i pronësisë vetë dhe sigurisht duhet të paraqitet të paktën edhe më vonë ku udhëzimet e tjera se si do të vazhdojë edhe paketa e maleve. Duhet të ketë edhe një përcaktim që kjo pronë do ti jepet kërkuesit për ta vërtetuar nëse është pronar, nëse është poseidues këto 10 vjet. Pra siç ne të gjithë e dimë, për ta vërtetuar këtë duhet një shkresë zyrtare që Agjensia Shtetërore e Kadastrës që vërteton që ai nuk ka titull pronësie. Tatimet gjithashtu e vërtetojnë nëse ai është i regjistruar dhe këtë po e përdor. Gjykata jep vërtetimin nëse ka konflikte për të drejtën. Deklarata noteriale më pas dhe njësia administrative që e vërteton.

Megjithatë, për këtë që po flasim po jua shpjegoj edhe njëherë. Janë hapa të mëvonshëm, ne jemi në fazën paraprake deri në vlerësimin nga qeveria nëse do shpallen apo jo zona prioritare. Të gjitha kërkesat që kanë ardhur në bashkinë e Durrësit nuk është e thënë që ato kërkesa do të vazhdojnë. Rast pas rastit do ti vihen në dispozicion Këshillit Bashkiak për t’i vlerësuar dhe dokumentacionin përkatës që do ta shoqërojë dhe nëse e justifikojnë këtë investimin që kanë. Kështu që në këtë fazë që po flasim për poseiduesin dhe pronarin edhe për komunitetin që pretendon nga këshilltar, z. Çuni, i lehet një hapësirë 45 ditore për pretendimet për të tretët. Në rast se të gjitha dokumentat e kërkuara vërtetojnë që është një tokë shtet. Pra, toka shtet duhet marrë parasysh që duhet të jetë e përjashtuar nga AMTP-ja. Çfarë nënkupton që nuk është dhënë asnjëherë me kthim kompensim prone dhe është e paregjistruar, pasi në këtë rast nuk jemi duke folur për një tokë shtet por po flasim për një tokë me dy pronar të paregjistruar. Kështu që ndodhemi në këto kushte, nuk duhet të ketë asnjë konflikt, pra toka duhet të jetë e pastër shtet dhe nëse ka raste për pretendime, konflikte gjyqësore, vendime gjyqësore e me radhë duhet të vërtetohen dhe nuk duhet të miratohet edhe vazhdimi i këtij projekt.

Hekuran Markola: Tek lista që na dërguat për aplikimet, kishte aplikime të Spitalës...

Alneida Rroshi: Ato janë të gjitha, unë jua kam servitur të gjitha çfarë është në sistem. Do përjashtohen se nuk është fare në listën e zonës për zhvillim. Ato kanë të drejtë të shprehin interes.

Emiriana Sako: Janë 125-127 aplikant. Vendosim këto zona kodrinore për qytetin e Durrësit dhe të gjitha rastet, rast pas rasti do shqyrtohen. Sot nuk po miratojmë as përfituesit, prandaj janë procedurat, të cilat do të vazhdojnë me Ministrinë e Shtetit për Administratën Publike, me verifikimet në ASHK, etj me radhë, janë njëserë dokumentash.

Ne sot po themi, për ne këto zona mund të kenë një interes potencial dhe këtë miraton këshilli sot, domethënë këtë i kemi propozuar këshillit. Pastaj të gjithë shqetësimet e qytetarëve, unë ju ftoj të gjithë ju që t'i përcillni, t'jua vëmë në dispozicion edhe listën edhe pretendimet e qytetarëve të tjerë, komuniteteve që përfaqësoni dhe të mbrojmë interesin e përbashkët të komunitetit. Pra siç ngrejti shqetësimin për banorët e Armathës aty, mund të ketë edhe raste të tjera që banorët nuk janë dakort, këto janë çështje që siç e përmendi nenin edhe pikën, janë të përcaktuara në ligj, që duhet dakordësia, nuk duhet të ketë konflikte nuk duhet të..., prandaj nuk po i miratojmë sot përfituesit, nuk i miraton fare bashkia përfituesit. Kanë një komision tjetër që vlerëson teknikisht aplikimet, planet ë bizneseve, sipërfaqen që do të marrësh, vizibilitetin, vitet se ku do ti ndërtosh etj me radhë, dhe më tej merren vendimet. Po për të gjitha këto hapa, njësitë vendore me përfaqësuesit e njësive administrative do të jenë në terren dhe do të japin opinionin e tyre. Kaq, pastaj unë mendoj që është mundësi për qytetin kjo.

Llesh Çuni: O kryetare unë jam dakort me thelbin me sqarimin...

Emiriana Sako: Ti e ngre shumë mirë atë shqetësim që ke ti, do ta ndjekim ne patjetër ku do përcillet, sepse as ne nuk duam që të vijë një person nga hiçi dhe të pretendojë që të marri ato toka. Qëllimi i ligjit është që ato që nuk kanë dot dokumentat e pronësisë të kenë një mundësi që ta zhvillojnë atë pronë. Po jo të vijnë nga qytete të tjera.

Llesh Çuni: Dhe ju mund të ngarkoni punonjësit stafin tuaj ta verifikojnë.

Emiriana Sako: Patjetër ato do ta bëjnë, por juve do t'ju vejmë në dispozicion edhe listën e aplikantëve, për çdo njësi administrative përfaqësoni zona të caktuara, ta keni atë material edhe na jepni dhe opinionin tuaj apo informacioni që ju vjen nga terreni që tashmë e dini.

Llesh Çuni: Dakord

Joniada Musaraj: Atëherë faleminderit.

Komente të tjera ka në lidhje me pikën 8 ?

Komente nuk ka. E kalojmë në votim.

Vota pro...? 27 vota pro.

Kundër?... 8

Abstenim?..... nuk ka.

Atëherë miratohet me 27 vota pro, 8 kundër, asnjë abstenim, pika 8 e rendit të ditës.

Faleminderit.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 9** Komisionit të Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit, z. Ermal Braholli.

Ermal Braholli : Komisioni u mbledh dhe ra dakord ta kaloj për votim në këshill.

Joniada Musaraj: Për Komisionin e Rregullores, Çështjeve Juridike flas unë. Atëherë në lidhje me pikën 9 komisioni ynë me shumicë votash e miratoi dhe fton këshillin që të japi votën pro. Faleminderit.

Atëherë komente ka në lidhje me pikën 9 ?

Komente nuk ka. E kalojmë në votim.

Kush është pro ? 36 vota pro.

Kundër?.... s'ka

Abstenim?..... nuk ka.

Atëherë miratohet me 36 vota pro pika 9 e rendit të ditës.

Rolant Xhelilaj : Mund ta marr fjalën.

Joniada Musaraj: Po z. Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Siç e dimë pas përfundimit të ushtrimit të funksionit të kryetarit të Këshillit Bashkiak nga z. Ani Dyrmishi, është krijuar vakancë në drejtimin e këtij organi kolegjal, dhe këtë detyrë e ka kryer zëvendëskryetarja znj. Denisa Luarasi. Për këtë vakancë disa mujore Sekretaria e Këshillit na ka kërkuar me email të bëjmë propozimet përkatëse. Gjithashtu nga Sekretaria e Këshillit jemi vënë në dijeni dhe për dorëheqjen e zëvendëskryetares së Këshillit Bashkiak të opozitës. Në përputhje me rregullat, ligjet përkatëse, nenet përkatëse, rregulloren, grupi jonë u përgjigj dhe do kisha dëshirë që sekretarja dhe kryetarja që drejtoi seancën sot, në kushte jo shumë të mira shëndetësore, që në fillim duhet ta kishte vënë në dukje që përveç rendit të ditës është dhe një kërkesë, e cila përputhet me përgjigjen e problemit që shtruat ju. Duke qenë fundi i vitit, duke dashur që të urojmë njëri tjetrin për një vit të mbarë, është e domosdoshme që në vitin 2026 të shkojmë edhe me një strukturë drejtuese të plotësuar. Në përputhje me kërkesën, në brëndë kohës mbledhëm grupin, përcaktuam emrat, prurim përgjigjet, të cilat unë i shtroj sot për miratim në këtë mbledhje. Grupi i këshilltarëve të PS-së, duke pasur të drejtën e zgjedhjes së kryetarit, meqëse kryetari, ish kryetari i Këshillit Bashkiak është sot deputet, propozon që zv/kryetarja e këshillit në fazën e një periudhe 4-5 mujore të drejtimit të këshillit në mënyrë shumë të mirë nga Denisa Luarasi, zonjën Denisa Luarasi ta propozojmë për kryetare këshilli dhe në vënd të zonjës Denisa, atë që sot për një seancë u bë kryetare e Këshillit Bashkiak Joniada Musaraj, si zëvendëskryetare e këshillit.

Në fakt prisnim reagim më të shpejtë nga opozita, për faktin, sepse zëvendëskryetarja që përfaqëson opozitën përveç kërkesës që ka paraqitur te ju, ka bërë edhe një deklaratë publike nëpërmjet shtypit që tërhiqet, më duket se grupi përkatës që i përkiste zonjës Devolli s'ka asnjë sot. Pjesa tjetër e opozitës duhet të plotësonte kërkesën që ju bë. Kjo është e drejta e tyre, ne kërkojmë që propozimi jonë të merret në konsideratë në këtë mbledhje dhe të kalojë në votim.

Joniada Musaraj: Pra, të zgjidhen në dhjetor.

Atëherë unë kam një propozim, nuk e di nëse jeni dakort dhe nuk besoj se rregullorja e pengon që të zgjidhet sot kryetari dhe nënkryetari nga pjesa e mazhorancës, për emrat që ne propozojmë si grupim dhe nëse ju keni nevojë për kohë dhe për të gjetur një emër të përshtatshëm.

Nuk e di si mendoni zoti Xhelilaj, jam okej?

Dritan Burgija : Në lidhje me këtë, në lidhje me këtë në email-in që na ka ardhur ne si kryetar grupesh nuk ishte specifikisht e thënë që do bëhet sot kjo gjëja, thotë në mënyrë në momentin më të parë të mundshëm na e sillni, nëse do na kishte ardhur një email me datë fikse do kishim marrë masat që dhe ne të ishim gati sot.

Joniada Musaraj: Kërkesa kur vjen me email do të thotë që presim përgjigje nga ju..

Dritan Burgija: Po presim përgjigje po nuk i vutë një datë.

Pastaj kjo është për t'u shtuar në rend dite, kjo është pikë rend dite, apo jo ?

Joniada Musaraj: Ka ardhur...

Absolutisht nuk e pengon.

Dritan Burgija: Si the ?

Joniada Musaraj: Nuk e pengon si pikë.

Dritan Burgija : Mirë më mirë, e pengon se pengon...

Joniada Musaraj: Epo unë e kam shumë merak rregulloren zoti Burgija kështu që.....

Dritan Burgija : Po pra dakord, nëse ju doni të kaloni kryetarin edhe nënkryetarin tjetër s'ka problem kaloni.

Ardian Muka: Lejeni për janar që ta fillojnë me këmbë të mbarë dhe ato, mos ta mbyllim fundvitin.

Joniada Musaraj: Zoti Xhelilaj dua qëndrimin tuaj.

Llesh Çuni : Ne duam ta votojmë sot.

Joniada Musaraj: Të lutem, të lutem zoti Çuni.

Unë dua mirëkuptimin tuaj, unë dua mirëkuptimin tuaj zoti Xhelilaj nëse a jemi okej me rregulloren?

Rolant Xhelilaj: Jam okej , po.

Joniada Musaraj: Ta bëjmë sot për kryetarin dhe nënkryetarin, emrat që do të propozojmë sot si grupim dhe pastaj opozita le të marri kohën e vet.

Rolant Xhelilaj: E di pse duhet ta theksoj dhe këtë sepse tha procedurë. Po pra kjo është procedura. Do ishte paraqitur në fillim të mbledhjes. Bëmë një lloj autokritike të vogël për gjëndjen gripale të kryetares në detyrë zonjës Luarasi që duhet të thoshte kërkesën e grupit tonë se kërkesa është aty me shkrim, po e duan jepja ta shohin. Dhe fakti që s'ke përcaktuar datë, nuk

do të thotë që kjo mund të shtyhet dhe për në fund të vitit tjetër. Është dëshirë e tyre që të mos ta japin sot. Ok, ne jemi dakort. Në mbledhjen janarit të bëjnë ç'të duan. Unë propozoj që të kalojë në përputhje të plotë me procedurën dhe me rregulloren e Këshillit Bashkiak, madje propozoj që të kalojë me votim të hapur.

Joniada Musaraj: E para që s'ke ndezur mikrofonin zoti Konesha.

Atëherë ta hedhim në votim propozimin e zotit Xhelilaj?

Të shtohet, të shtohet. Jeni dakord?

Atëherë a jeni dakort që të shtohet si pikë sot në rendin e ditës, të votohet për zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarit që propozohet?

Të shtohet kjo pikë. Jeni dakord? Kush është pro?

Jeni dakord? Po numëroji

Atëhere, kundra ka? 8

Abstenim nuk ka.

Atëherë, me 28 vota pro shtohet si pikë 10 e rendit të ditës zgjedhja e kryetarit dhe nënkryetarit.

Joniada Musaraj: Po. Atëherë 10..

Atëhere, atëhere propozimi i zotit Xhelilaj për kryetare të këshillit bashkiak është zonja Denisa Luarasi propozoj ta bëj me votim të hapur...

Ardian Muka : U bënë shumë propozime. Një ta bëjmë një herë dhe pastaj....

Derisa rregullorja e ka që votimi duhet bërë i fshehtë.....

Joniada Musaraj: Po se pengon të hapur....nuk e pengon të hapur...

Ardian Muka: Atëhere do ishte besoj më normale që përderisa ne votojmë të kishim të paktën dy kandidatura. Se përndryshe për çfarë votojmë? Natyrisht juve te PS-ja kështu votoni me thënë të drejtën. Po jo nuk votoni për emra, por është normale që në këto lloj institucionesh ku keni dhe njerëz që ju monitorojnë, ku janë dhe kamerat, është dhe opozita, votimi duhet të jenë minimalisht dy persona dhe përderisa është me votim të fshehtë, duhet të bëhet me votim të fshehtë.

Joniada Musaraj: Atëherë që të jesh i qetë dhe po e bëmë të hapur, e kemi për emrat që propozojmë ne sot, kështu që ta hedhim në votim, kush është dakort, vota pro për kryetare e këshillit bashkiak zonja Denisa Luarasi ?

Numëroji

Dorina Milja : 27

Joniada Musaraj: Kundra..?

Atëhere, të lutem...të lutem....

Dorina Milja : Kundra 5.

.....Shumë zhurmë, flasin të gjithë

Joniada Musaraj: Të lutem, të lutem...
Abstenim tre...

Flutura Kasa: Denisa a e sheh sa të don opozita.

Joniada Musaraj: Të lutem

Po po atëherë të lutem na lini të numërojmë votat dhe t'ju japim dhe përgjigjen.

Flisni të gjithë njëherësh pa ju dhënë fjala.

Atëhere me 27 vota pro, 5 kundër dhe 3 abstenime zgjidhet kryetarja e Këshillit Bashkiak, zonja Denisa Luarasi.

Suksese zonja Denisa. Mbarë e mirë dhe të kesh këmbën e mbarë për vitin 2026.

Atëhere meqënëse...

Denisa Luarasi: Të falenderoj.

Joniada Musaraj: Të mbarojmë dhe Ok mbaro.

Denisa Luarasi: Përshëndetje.

Po, shumë faleminderit për besimin. Është nder dhe privilegj për mua, por dhe një përgjegjësi shumë e madhe për të punuar me transparencë dhe për të qenë një zë për të përcjellë çdo problem dhe për të mbështetur çdo kontribut në emër të qytetarëve dhe për qytetin tonë Durrës. Falenderoj shumë dhe Joniadën për mbështetjen, për suportin. Ishe fantastike sot. Faleminderit.

Joniada Musaraj: Faleminderit zonja Luarasi.

Denisa Luarasi: Dhe ju uroj festa të gëzuara dhe një vit të mbarë.

Joniada Musaraj: Është herët.

Denisa Luarasi: Ok.

Joniada Musaraj: Atëhere, ju lutem kalojmë dhe në votimin e dytë për nënkryetare.

Ja kaloj stafetën zonjës Denisa meqënëse u zgjodh.

Shumë faleminderit të gjithëve për mirëkuptimin dhe mbështetjen sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Atëherë ju ftoj në votim për zonjën Joniada Musaraj si nënkryetare e Këshillit Bashkiak Durrës.

Jo ti nuk voton Joniad.

Me 27 vota pro miratohet .

Suksese Joniada. Suksese dhe mbarësi.

Dorina Milja : Jo prit ...

Sa kundër ? Një, dy, tre, katër, pesë...

3 abstënim.

Joniada Musaraj: Faleminderit, faleminderit të gjithëve.

Denisa Luarasi: Ta gëzosh.

Joniada Musaraj: Faleminderit.

Denisa Luarasi: Mirupafshim, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.
Shihemi mbledhjen e radhës.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 39 (tridhjetë e nëntë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga 2 drejtues të seancës, sekretari i këshillit dhe 2(dy) këshilltarë.

Mbajtësi i procesverbalit: Nikol Muka

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Drejtues i seancës (Kryetar i Këshillit Bashkiak) :	DENISA LUARASI
Drejtues i seancës (Zv/kryetar i Këshillit Bashkiak) :	JONIADA MUSARAJ
Sekretar i Këshillit Bashkiak :	DORINA MILJA
Këshilltarë (Kr. Grupi):	ROLANT XHELILAJ
Këshilltarë (Kr. Grupi):	FLUTURA KASA